



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRENDSHME  
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

V E N D I M

PËR SUBJEKTIN E VLERËSIMIT NERITAN NALLBATI

Nr. 14, datë 20.02.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

<b>Kleada Mersinllari</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Edona Dushaj</b>	<b>Relatore</b>
<b>Enton Radovani</b>	<b>Anëtar</b>

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtare e Sekretariatit Teknik, znj. Ersila Kalaja, në datën 20.02.2024 ora 10:00, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket

**SUBJEKTI I VLERËSIMIT:** **Neritan Nexhat Nallbati**, me funksion aktual, Drejtor i Departamentit të Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

**OBJEKTI:** Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** **Ligji nr. 12/2018** “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

**Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**Ligji nr. 49/2012** “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

## TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi relatimin e relatores së çështjes Edona Dushaj; dëgjoi subjektin e vlerësimit, z. **Neritan Nallbati**, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 14.02.2024, kërkoi konfirmimin e tij në detyrën e Drejtor të Departamentit të Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në tre kriteret e vlerësimit të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të ligjit 12/2018, i ndryshuar,

### V Ë R E N:

#### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi Z. Neritan Nallbati është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit të parë datë 05.04.2023 si “Drejtor i Departamentit të Policisë Kriminale, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.”
3. Subjekti i vlerësimit, **Z. Neritan Nallbati** iu nënshtroa procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar 05.04.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7 datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin 1, datë 18.04.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: Znj. Edona Dushaj Relatore, Znj. Kleada Mersinllari Kryesuese dhe Z. Enton Radovani, Anëtar.
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin nr., 1, datë 18.04.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Neritan Nallbati.
6. Relatori i çështjes, Znj. Edona Dushaj, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 18.04.2023 ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar,

dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.

7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në datën 20.04.2023 duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Në vijim të procesit të mbështetur në nenet 33/1, nenin 42, nenin 46 të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, relatori i çështjes ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse deklaratimet e subjektit të vlerësimit, si më poshtë vijon:
  - a. me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 19.04.2023, ka dërgua pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin shoqërues;
  - b. me shkresën nr.\*\*\* prot, datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit deklaratën e vlerësimit të aftësive profesionale;
  - c. me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, deklaratën e kontrollit të figurës.
10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
  - ✚ vlerësimin e pasurisë;
  - ✚ kontrollin e figurës;
  - ✚ vlerësimin e aftësive profesionale.
12. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
  - a. Ligji nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
  - b. Ligji nr.128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”
  - c. Ligji nr.40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”

- d. Ligji nr.49/2012 “Për gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”
- e. Ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”
- f. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7, datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”
- g. Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”.
- h. Duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht deklaratat e dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit që janë:

-  *Deklarata e Pasurisë,*

-  *Deklarata për Kontrollin e Figurës,*


-  *Formulari i Vlerësimit Profesional*


-  *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet.*

- i. Raportet përmbledhëse të ILDKPKI-së, Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit në AMP, dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- j. Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.
- k. Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.
- l. ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.

13. Trupa e vlerësimit, më datë 02.02.2024 pasi dëgjoji relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Neritan Nallbati, me Vendimin nr. 03, datë 02.02.2024 vendosi;

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Neritan Nallbati ;
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:

-  *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*

-  *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*

- c. Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit , në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme , prej 5 ditëve për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

14. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 3, pika 12,14, e Ligjit

nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar

15. Në datën 14.02.2024, trupa e vlerësimit, njoftoi subjektin e vlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 14.02.2024 ora 10:00, në ambiente e sallës së mbledhjes së Ministrisë së Brendshme, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

Seance dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Neritan Nallbati, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit kishte zgjedhur të mos përfaqësohej me mbrojtës ligjor në këtë seancë. Në fund të seancës dëgjimore të datës 14.02.2024, subjekti i vlerësimi z. Neritan Nallbati kërkoi konfirmimin në detyrë. Në datën 20.02.2024, trupa e vlerësimit shpalli vendimin.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT**

Me subjektin e vlerësimit është komunikuar me anë të postës elektronike, duke i bërë pyetje dhe kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave. Subjekti i vlerësimit z. Neritan Nallbati, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të vlerësimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë hetimit.

### **A. VLËRËSIMI I PASURISË**

16. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
17. Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit Z. Neritan Nallbati, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 09.03.2023. Formulari i Pasurisë ka nr.14 index, viti 2023 .
18. Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33 ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.

19. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridik, publikë apo privatë.
20. Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklaratimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34 , shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

## **21. Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:**

- ✚ deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
- ✚ raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
- ✚ provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
- ✚ dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

## **22. Hetimi administrativ konsistoi në:**

- ✓ verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

## **23. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja;**

ILDKPKI-ja, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar një raport<sup>1</sup>, të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Neritan Nallbati, ku është konstatuar:

---

<sup>1</sup> Raporti nr. 1/33, datë 27.09.2023, i ILDKPKI-së.

- ✓ deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjshme burimet e ligjshme financiare;
- ✓ nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- ✓ nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- ✓ çnuk ka kryer deklarim të rremë;
- ✓ subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

## **A. PROCEDURA E VLERËSIMIT/HETIMIT E KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT**

24. Bazuar në nenin 34, të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e vlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, (b) raportin/vlerësimin e kryer nga ILDKPKI; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private sipas nenit 34 të ligjit 12/2018; (ç) deklaratimet e subjektit të vlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit; (dh) deklaratimet në seancë dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.
25. Trupa e Vlerësimit hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllimin evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (ik) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo ndonjë konflikti të interesit.

### **DEKLARIMI I SUBJEKUT TË VLERËSIMIT, NERITAN NEXHAT NALLBATI** **DEKLARIMI I PASURIVË**

*Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si vijon:*

#### **Pasuria nr. 1.**

1. Apartament banimi në adresën Rr. “\*\*\*\*”, Nd. \*\*\*, H. \*\*\*, Ap. \*\*\*\*Tiranë, me sip. 112.30 m<sup>2</sup>, në emër të Neritan Nallbati me certifikatë pronësie, e reregjistruar më datën 1.11.2016, në nr. pasurie \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*. Kjo pasuri është përfituar nga një Kontratë Prenotimi me nr. \*\*\*, datë 09.10.1998, me firmën “\*\*\*\*”. Vlera 1.800.000 lekë. **Burimi i Krijimit:** 1550.000 lekë nga kursimet e të ardhurave dhe shpërblimeve ndër vite dhe shlyerja është bërë ndër vite. 250.000 lekë të ardhura nga prindërit në vitin 1998 e vërtetuar me deklaratë. Zotëron 100%.

## Bashkëlidhur Deklaratës

- Kontratë Prenotimi apartamenti, nr. \*\*\*, datë 09.10.1998 me prenotues Neritan Nallbati. Apartament 2+1, i cili ndodhet në katin e 4 dhe shuma e parapaguar në datën e lidhjes së kontratës 1.800.000 lekë.
- Leje Legalizimi nr. \*\*\* datë 04.08.2011 Shtesë kati për banim, në objektin ekzistues 3 kate, në emër të Neritan Nallbati dhe I.B. Zona \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*, shtesë sip. ndërtimi 216.8 m<sup>2</sup>, sipërfaqe totale për banim 227.6 m<sup>2</sup>, numri i kateve 3 + 1, sipërfaqe shkallë 10.8 m<sup>2</sup>. Bashkëlidhur; Planimetria e katit të tret më sipërfaqe banimi 112.3 m<sup>2</sup>, më posedues Neritan Nallbati + genplan i objektit, kati i 4, ap.6, më sip shtesë 112.3 m<sup>2</sup>, në emër të poseduesit Neritan Nallbati.
- Certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, për apartament më sip. 112.30 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, vol.\*\*\*, fq. \*\*\*6, ZK. \*\*\* lëshuar në datë 01.11.2016 në emër të Neritan Nallbati. Bashkëlidhur kartela e pasurisë së paluajtshme, ku konfirmohet regjistrimi i pasurisë më Leje Legalizimi.

## Hetimi administrativ:

🚩 **ASHK, Drejtoria e Përgjithshme**, më shkresën nr. \*\*\*, datë 12.06.2023, konfirmon së Neritan Nexhat Nallbati, figuron vetdeklarues më;

- Nr. Prot -, datë -, formular 1993, Njësia nr.5, Tiranë,
- Nr. Prot -, datë -, formular 1993, Njësia nr.5, Tiranë.

🚩 **ASHK, DV Tiranë Jug**, më shkresën nr. \*\*\*prot, datë 26.06.2023, konfirmon pasurinë nr. \*\*\*, vol.\*\*\*, fq. \*\*\*, Zk \*\*\*, në emër të Neritan Nallbati.

Bashkëlidhur;

- Kartela e pasurisë së paluajtshme, apartament më sip. 112.30 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, në emër të Neritan Nallbati, ku konfirmohet regjistrimi i pasurisë në datë \*\*\* me Leje Legalizimi.
- Kërkesë, drejtuar Zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, nr. \*\*\*, shtator 2011, në emër të Neritan Nallbati.
- Dërgim dokumentacioni për objekte të legalizuara, nga ALUIZNI, nr. \*\*\* prot, datë 11.08.2011 \*\*, shtesë 1 kat për banim në objekt ekzistues 3 kat "Neritan Nallbati, I. B".
- Leje Legalizimi, nr. \*\*\*, datë 04.08.2011, shtesë 1 kat për banim, në objektin ekzistues 3 kat, për Neritan Nallbati dhe I. B., në adresën Njësia nr. 5, Tiranë, \*\*\*, nr. pasurie \*\*\* dhe \*\*\*, sip. ndërtimi 227.6 m<sup>2</sup>, numri i kateve mbi tokë 3+1, sip. shkallë 10.8 m<sup>2</sup>.
- Kartela e pasurisë së paluajtshme, apartament më sip. 112.3 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, në emër të Neritan Nallbati.
- Planimetria e katit të tret+ Genplan + fotot e objektit.
- Deklaratë Noteriale, nr.\*\*\* Rep, nr. \*\*\*1 Kol, datë 18.12.2007 nga I.H., S. D., S.Sh. dhe Xh. C.J, ku është deklaruar së janë banoret e pallatit në Rr. "\*\*\*\*", P. \*\*\* dhe deklarojnë se



në vitin 1997 ata kanë qenë dakord lidhur me ndërtimin e shtesës që kanë bere banorët e katit të sipërm të pallatit I.B. dhe Neritan Nallbati. Shtesa është ndërtuar dhe financuar nga I. B. dhe Neritan Nallbati.

- Vërtetim nga Dokumenti hipotekor, ku vërtetohet së në numrin hipotekor \*\*\*, datë 13.10.2011, figuron e regjistruar pasuria nr. \*\*\*ZK. \*\*\*, apartament më sip.112.30 m2, n emër të Neritan Nallbati, regjistruar më Lej Legalizimi.
- Harta treguese e regjistrimit + Planimetria e katit të tret.

**Në procesverbalin e datës 05.07.2023 dhe datës 31.07.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit subjekti ka sqarua: *“Në lidhje më vlerën e apartamentit të shënuar në kontratën e printimit, se kontratat në atë periudhë kohore ishin kontrata tip dhe vërtetonin marrëdhënien midis palave. Shlyerja e vlerës së apartamentit është bërë ndër vite, për shkak të dakortësisë së bërë më pronarin ndërtues të apartamentit. Në momentin e prenotimit shtëpia ishte e mbaruar dhe vetëm nuk ishte bërë lyerja dhe vendosja e hidrosanitareve. Vlera e investimit për këtë apartament është 1.800.000 lekë gjithsej. Duke qenë së firma ndërtuese nuk bëri certifikimin e objektit, u detyruan bashkë më komshiu I.B, të bënin kërkesë në Njësinë Administrative Nr. 5, për legalizim të apartamenteve të tyre. Apartamenti i subjektit ka sipërfaqe 112.3 m2, dhe ndodhet në katin e katërt, të një pallati katër katesh ”.*

Në deklarimin e bërë prej tij, në vazhdim ai sqaron se *“... pas vitit 1998, nuk ka bërë investime në punime përveç, pajisjes me hidrosanitare në momentin e marrjes së apartamentit, që janë në vlera modeste. Investimin për mobilimin e këtij apartamenti e ka bërë në disa vite, deri në vitin 2003. Kohë në të cilën është shkëputur nga banesa e vjehrrit të tij.*

*ASHK, në procedurën e regjistrimit ka vendosur vlerën e investimit prej 6.448.590 lekë dhe kjo është vlera e përlogaritur nga ASHK, si rezultat i llogaritjeve të tyre për llogaritjen e vlerës së taksës që duhej paguar, dhe jo vlera reale e investuar nga ana e tyre”.*

Gjithashtu ka sqaruar se: *“... shtesa e pallatit, kishte filluar në vitin 1997, nga ana e ndërtuesit P. V.. Ai e ka porositur në vitin 1998, kohë kur ndërtimi kishte mbaruar nga ana e ndërtuesit. Deklarata Noteriale nga banorët është bërë për efekt Legalizimi, duke qenë së ndërtuesi nuk përfundoi procedurat e regjistrimit të apartamentit atëherë u detyruan të bënin një kërkesë për legalizim në Njësinë Bashkiake nr. \*\*\*, Tiranë dhe për procedurë të legalizimit duhej edhe një deklaratë e banorëve për dakortësinë e tyre në kohën e ndërtimit, ndaj kjo deklaratë u mor për efekt legalizimit.*

*Arsyeja e pagesës me këste ka qenë si rezultat, i njohjes që ai kishte me ndërtuesin dhe gjithashtu për faktin së nuk ishte korrekt në përfundimin e punimeve dhe regjistrimit të saj në hipotekë dhe mos regjistrimit të apartamentit dhe dorëzimit të dokumenteve të pronësisë.*

*Në lidhje me shumën e investuar për blerjen e apartamentit, ka deklaruar së shuma e investuar për blerjen e apartamentit ka qenë 1.800.000 lekë, ndërsa për arredimin e brendshëm, fillimisht në vitet 1999, për hidrosanitare ka qenë rreth 25.000 lekë, me pas kompletimi është investuar ndër vite, pasi ai dhe familja e tij kanë jetuar deri në vitin 2003 tek babai i bashkëshortes dhe i është dhënë mundësia që ta arredojë pjesë pjesë.*

*Gjithashtu ka shpjeguar së orenditë e shtëpisë i ka marrë shumën të përdorura në disa firma, si p.sh orenditë elektroshtëpiake i ka marrë tek firma "\*\*\*\*" në Vlorë, me nr. tel. \*\*\*. Arredimi*

*i shtëpisë është bërë me mobilje të përdorura, ndriçues etj., në firmën "\*\*\*\*" me nr. tel. \*\*\*, në Tiranë.*

*Shuma e shpenzuar ndër vite, për arredimin bazë për një jetesë normale është rreth 450.000 lekë. Ka listuar orenditë e blera, si dhe vlerën përkatëse. Gjithashtu ka paraqitur pamje të orendive dhe arredimit të apartamentit”.*

### **Subjekti paraqiti :**

- **Deklaratë Noteriale** nr. \*\*\* Rep, nr. \*\*\*Kol, datë 25.01.2021, nga P. V., i cili ka deklaruar se ka nënshkruar një kontratë për prenotim apartamenti në vitin 1998 me Neritan Nallbati, nëpërmjet të cilës i ka shitur z. Neritan një banesë në vlerën 1.800.000 lekë. Kjo shumë, për shkak të miqësisë që ka me z. Neritan, kanë rënë dakord që të shlyhej më këste, dhe kjo dakortësi ka qenë i vetmi përjashtim që ka bërë në shitjen e të gjithë apartamenteve. Konkretisht shuma 1.800.000 lekë është paguar si më poshtë:
  - Nga viti 1998 deri në 2003, është likuiduar nga 7.000 lekë në muaj, në total 420.000 lekë.
  - Nga viti 2003 deri në vitin 2010, është likuiduar 15.000 lekë, në total 1.380.000 lekë.

Bashkëlidhur kopje të kartës së identitetit të z. P. V. + Kontratë Prenotimi nr. \*\*\*, datë 09.10.1998 më \*\*\*. Apartament 2 + 1 në vlerën e parapaguar 1.800.000 lekë.

- Dosjen e ASHK, ku përfshihen:
  - o Kartela e pasurisë së paluajtshme, apartament më sip. 112.30 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, në emër të Neritan Nallbati, ku konfirmohet regjistrimi i pasurisë në datë \*\*\* me Leje Legalizimi.
  - o Kërkesë, drejtuar Zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, nr. \*\*\*, shtator 2011, në emër të Neritan Nallbati.
  - o Ortofoto dixhitale. Planimetria e katit të tret, Genplan.
  - o Deklaratë Noteriale, nr.\*\*\* Rep, nr. \*\*\*1 Kol, datë 18.12.2007, nga I.H., S. D., S.Sh. dhe Xh. C.J, ku është deklaruar së janë banoret e pallatit në Rr. "\*\*\*\*", P. \*\*\* dhe deklarojnë se në vitin 1997 ata kanë qenë dakord lidhur me ndërtimin e shtesës që kanë bere banorët e katit të sipërm të pallatit I.B. dhe Neritan Nallbati. Shtesa është ndërtuar dhe financuar nga I. B. dhe Neritan Nallbati.
  - o Vërtetim nga Dokumenti hipotekor, ku vërtetohet së në numrin hipotekor \*\*\*, datë \*\*\*, figuron e regjistruar pasuria nr. \*\*\*\*ZK. \*\*\*, apartament më sip.112.30 m<sup>2</sup>, n emër të Neritan Nallbati, regjistruar më Lej Legalizimi.
  - o Harta treguese e regjistrimit + Planimetria e katit të tret.
  - o Lej Legalizimi nr. \*\*\*, datë 04.08.2011, shtesë kati për banim në objekt ekzistues 3 kate, në emër të Neritan Nallbati dhe I.B. , Zona kadastrale \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*, shesë sip. ndërtimi 216.8 m<sup>2</sup>, sipërfaqe totale për banim 227.6 m<sup>2</sup>, numri i kateve 3 + 1, sipërfaqe shkallë 10.8 m<sup>2</sup>. Bashkëlidhur; Planimetria e katit të tret më sipërfaqe banimi 112.3 m<sup>2</sup>, më posedues Neritan Nallbati. Ortofoto dixhitale. Njoftim për formularët e pagesave nga ALUIZNI, nr. 3686 Prot, datë 2.6.2011, drejtuar Neritan Nallbati dhe I.B. Tabela sqaruese,

konfirmohet shuma që duhet paguar nga I.B., 15.569 lekë dhe nga Neritan Nallbati, 16.674 lekë (total 32.243 lekë).

- Formulari i pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për objekte informale, datë \*\*\*, ku vlera e investimit është llogaritur 6.448.590 lekë dhe përqindja e taksës së aplikueshme 32.243 lekë. Faturë pagese nga Neritan Nallbati dhe I.B në Credins Bank, të shumës 32.243 lekë, në datë 03.06.2011.
  - Akt ekspertize nga Ing. A. Sh., mars 2010, "Ngritje kati 1 kat mbi objektin ekzistues 3 kat" me investitor I.B dhe Neritan Nallbati, në adresën Rr. "\*\*\*\*", pallati \*\*\*1, Tiranë.
  - Certifikatë për vërtetim pronësie, pasuria nr. \*\*\*, ZK. \*\*\*, apartament më sip. 112.30, në emër të Neritan Nallbati, lëshuar në datë 01.11.2016. Në seksionin "D", shënimi "Pasuria u rivlerësua në vlerën 14.789.910 lekë", sipas aplikimit më nr. \*\*\*, datë 24.10.2016 Kartela e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, apartament më sip. 112.30 m2, në emër të Neritan Nallbati, lëshuar në datë 08.03.2010. Harta treguese e regjistrimit, për pasurinë nr. \*\*\*\* në emër të Neritan Nallbati. Lej Legalizimi nr. \*\*\*, datë 04.08.2011. Planimetri e katit të tret. Genplan i pasurisë nr. \*\*\*, apartament më sip. 112.3. m2, në emër të Neritan Nallbati
  - Leje Legalizimi, nr.\*\*\*, datë 04.08.2011, shtesë 1 kat për banim, në objektin ekzistues 3 kat, për Neritan Nallbati dhe I. B., në adresën Njësia nr. 5, Tiranë, \*\*\*, nr. pasurie \*\*\* dhe \*\*\*, sip. ndërtimi 227.6 m2, numri i kateve mbi tokë 3+1, sip. shkallë 10.8 m2.
  - Foto të apartamentit, ku është vijëzuar apartamenti në zotërim të subjektit (4 copë).
- Lidhur me vendbanimin nga viti 1992 deri në vitin 2003.

**Në procesverbalin e datës 05.07.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit subjekti ka sqarua: *“Së bashku më bashkëshorten e tij dhe dy vajzat Laura dhe Levia, kanë banuar në banesën e vjehrrit të tij R. I. me adresë Rr. “ \*\*\*\*”, pallati \*\*\*, ap. \*\*\*, Njësia Administrative nr. \*\*\*, që nga data 30.5.1992 deri në muajin tetor të vitit 2003 dhe për këtë periudhë kohore të gjitha shpenzimet për qëndrim në banesë dhe ushqim janë mbuluar nga vjehrrit dhe vjehrra e tij”*.

#### **Subjekti paraqiti:**

- Deklaratë Noteriale nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* Kol, datë 17.02.2021, nga R. I. dhe Neritan Nallbati, ku R.I., ka deklaruar së vajza e tij Nertina Nallbati, së bashku më bashkëshortin e saj dhe dy vajzat Laura dhe Levia, kanë banuar në banesën e tij më adresë "Rr. \*\*\*\*", pallati \*\*\*, ap.\*\*\*, Njësia Administrative nr. \*\*\*, që nga data 30.05.1992, deri në muajin tetor të vitit 2003 dhe për këtë periudhë kohore të gjitha shpenzimet për strehim dhe ushqim, kanë qenë në ngarkim të tij. Neritan Nallbati, ka deklaruar së sa më sipër është i saktë dhe për këtë periudhë kohore ka qenë i pajisur më leje banimi. Bashkëlidhur; Certifikatë familjare datë 28.01.2021, më kryefamiljar Neritan Nallbati, ku theksohet së; "kjo është gjendja familjare në datë 30.05.1992, ardhur nga ZGJC Korçë dhe larguar në datë 04.03.2013, nga ZGJC 2".
- Vërtetim nga ISSH, Drejtoria Rajonale Tiranë, datë 21.01.2021, ku vërtetohet se R.I., trajtohet më pension pleqërie me masë mujore 31.846 lekë/muaj dhe pension suplementar pleqërie me masë pensioni 13.572 lekë/muaj. Të ardhurat nga data e fillimit të pensionit të

pleqërisë 01.04.1983, deri në 31.12.2020, si dhe të pensionit suplementar nga 1.07.2009, në total janë 7.688.965 lekë. Të ardhurat nga pensioni si veteran për periudhën 1.12.1994 - 30.6.2003, në shumën rreth 163.792 lekë dhe nga pensioni i pleqërisë për periudhën 1.4.1983 - 30.11.2003, në shumën totale rreth 868.204 lekë.

- Vërtetim nga ISSH, Drejtoria Rajonale Tiranë, datë 21.01.2021, ku vërtetohet se A.I., trajtohet me pension pleqërie me masë mujore 19.994 lekë/muaj. Të ardhurat nga data e fillimit të pensionit të pleqërisë 01.09.1993 deri në 31.12.2020, në total janë 3.835.721 lekë. Të ardhurat nga pensioni për periudhën 01.09.1993 - 30.11.2003, në shumën rreth 616.299 lekë.
  - Vërtetim nga Njësia Administrative nr. \*\*\* Tiranë, datë 23.03.2023, ku konfirmohet së Nertina Nallbati, ishte banuese e Njesisë nr. \*\*, në adresën Rr. "\*\*\*\*", pallati \*\*, hyrja \*\*.
  - Certifikatë familjare nga Zyra e Gjendjes Civile \*\*, Njësia Administrative nr. \*\*\* Tiranë, datë 29.06.2023, me kryefamiljar Neritan Nallbati, ku konfirmohet se familja ka ardhur nga ZGJC, Njësia nr. \*\*, në datë 04.03.2013.
  - Certifikatë familjare nga Zyra e Gjendjes Civile \*\*, Njësia Administrative nr. \*\*\* Tiranë, datë 29.06.2023, me kryefamiljar Neritan Nallbati, ku konfirmohet se familja është vendosur në ZGJC nr. \*\*, në datë 30.05.1992, kur ka ardhur nga ZGJC Korçë libri \*\*\*\*dhe larguar në datë 04.03.2013, në ZGJC Njësia nr. \*\*, Tiranë.
- Lidhur me vlerën e 250.000 lekë, dhuruar nga prindërit, vlerë e përdorur për blerjen e apartamentit.

**Në procesverbalin e datës 05.07.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit subjekti ka sqarua: *“Në gusht të vitit 1998 ka marrë dhe një ndihmë financiare nga prindërit e tij, e vërtetuar kjo me Kontratën noteriale nr. \*\*\* Rep. \*\*\* Kol, datë 27.01.2021”*.

#### **Subjekti paraqiti:**

- **Deklaratë Noteriale** nr. \*\*\* Rep, nr. \*\*\* Kol, datë 27.01.2021, nga Nexhat Nallbati, ku deklarohet se në muajin gusht 1998, i ka dhënë djalit të tij Neritan Nallbati, një shumë prej 250.000 lekë, shumë e cila që në formën e dhuratës nga ana e tij, pasi në atë kohë nuk i’ u realizua dëshira për ti organizuar një dasmë djalit të tij dhe për ketë qëllim i dhuroi shumën e sipërcituar. Kjo shumë është e justifikuar me të ardhurat e asaj kohë së bashku me kursimet.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme nga DRSSH Korçë, për N. N., ku konfirmohet së për vitin 1994 - 1995, nuk disponohet dokumentacioni për pagesat kalimtarë të përfituara nga ushtarakët.
- Akt verifikimi i vjetërsisë në punë, para vitit 1994, nga DRSSH Korçë, ku konfirmohet së "për repartin ushtarak nr. \*\*, nuk disponohet dokumentacion".
- Vërtetim nr. \*\*, datë 20.03.2012, për pagën referuese për periudhën e trajtimit financiar të ushtarakëve, sipas VKM 225, datë 29.05.1992 dhe VKM 7, datë 10.01.1996, nga Reparti Ushtarak nr.1601 Korçë. Konfirmohet së N.N, ish efektiv në Repartin Ushtarak nr.3699 Libonik ka dalë në rezervë, lirim me Urdhër nr. 2325/1, datë 02.07.1992 dhe në ketë moment, ushtronte funksionin organik Shef kuadri B. K. Paga e funksionit organik

mbi të cilën është llogaritur trajtimi financiar për periudhën 20.07.1992 - dhjetor 1995, është rreth 204.852 lekë.

- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, nga ISSH, ku konfirmohen të ardhurat nga paga për N.N., për periudhën maj 1997-korrik 1999, në shumën neto 252.579 lekë.
- Vërtetim nga DRSSH Korçë, për bazën e vlerësueshme për D. N. Konfirmohen të ardhurat mbi bazën e të cilave është derdhur kontributi për periudhën 01.01.1994 - dhjetor 2002, në shumën rreth 706.690 lekë.

### **Konkluzion:**

- ✓ Bazuar në deklarimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur rezulton se; Apartamenti me sip. 112.30 m2, në Rr. "\*\*\*\*", Tiranë, në zotërim 100% të subjektit deklarues është përfituar me kontratë prenotimi të vitit 1998 dhe regjistruar me Leje Legalizimi të vitit 2011 Apartamenti është deklaruar i prenotuar në vitin 1998, në shumën 1.800.000 lekë, shumë e likuiduar deri në vitin 2010, me burim të ardhurat familjare ndër vite, si dhe një pjesë dhuratë nga prindërit e tij, në vitin 1998. Gjithashtu subjekti ka deklaruar se si burim ka shërbyer edhe ndihmesa që i kanë dhënë prindërit e bashkëshortes, për periudhën ku kanë qëndruar
- ✓ Subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues dhe burimin e krijimit të pasurisë, lidhur me apartamentin me sip. . 112.30 m2, konfirmuar nga ASHK.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar, lidhur me pronësinë e apartamentit me sip. 112.30 m2, në Rr. "\*\*\*\*", në emër të subjektit.
- ✓ Shuma e shpenzuar ndër vite për mobilimin e apartamentit është rreth 475.000 lekë.

### **Pasuria nr. 2**

Automjet vetura "Mitsubishi", në emër të Neritan Nallbati, blerë në vitin 2005.

Vlera: 500.000 lekë.

**Burimi i krijimit:** Nga të ardhurat e krijuara nga kursimet familjare. Zotëron 100%.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë Blerje automjeti nr.\*\*\*Rep, nr. \*\*\* Kol, datë 06.06.2005, Mitsubishi Pajero, nr. shasie\*\*\*\*\*, me targë DR\*\*\*C, në vlerën 500.000 lekë. Palë blerëse Neritan Nallbati.
- Kontratë Shitje automjeti nr. \*\*\* Rep, nr. \*\*\*Kol, datë 11.02.2015. Automjet Mitsubishi Pajero nr. shasie \*\*\*\*\*, me targë TR\*\*\*K në shumën 400.000 lekë. Palë shitëse Neritan Nallbati.

### **Hetimi administrativ**

✚ **DPSHTRR**, me shkresën \*\*\*, datë 08.05.2023, nuk konfirmon mjet të regjistruar në pronësi të subjektit dhe personave të lidhur me të.

✚ **DPSHTRR**, me e-mailin e datës 24.05.2023, konfirmon se mjeti me nr. shasje \*\*\*\*\*, nuk është i regjistruar në DPSHTRR.

### **Konkluzion:**

- ✓ Automjeti "Mitsubishi Pajero" është blerë nga subjekti në vitin 2005, në shumën 500.000 lekë dhe është shitur në vitin 2015, në shumën 400.000 lekë.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.
- ✓ Nuk konfirmohet automjeti nga DPSHTRR.

### **Pasuria nr. 3**

Shtëpie në \*\*\*Vlorë, me sipërfaqe 56.7 m2, në shumën 3.419.010.lekëë.

**Burimi i krijimit** të kësaj pasurie është nga kursimet e të ardhurave familjare ndër vite. Zotëron 100%.

Shitje e shtëpisë në \*\*\*Vlorë, me sipërfaqe 56.7 m2, me datë 24.07.2013. (çmimi 25.000 euro. Pjesë takuese 100%

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë blerje pasuri e paluajtshme nr. \*\*\* Rep, nr. \*\*\* Kol, datë 03.04.2013. Palë shitëse shoqëria "\*\*\*\*" sh.p.k dhe palë blerëse Neritan Nallbati. Apartament me sip. totale 50.7 m2, nr. pasurie \*\*\*, ZK. \*\*\*, "\*\*\*\*" Vlorë, në vlerën 3.419.010 lekë. Shumë e cila është paguar paraprakisht jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë Shitje pasuri e paluajtshme nr. \*\*\* Rep, nr. \*\*\* Kol, datë 24.07.2013. Palë shitëse Neritan Nallbati dhe palë blerëse Sh. B. Apartament me sip. 56.7 m2, nr. pasurie \*\*\*, ZK. \*\*\*, "\*\*\*\*" Vlorë, në shumën 25.000 Euro.
- Vërtetim nga dokumentet hipotekore, për pasurinë apartament me sip. 56.7 m2, nr. pasurie \*\*\*, në emër të Neritan Nallbati, lëshuar në datë 19.07.2013. Fatura pagese në Fibank nga Sh. B., datë 24.07.2013, e shumës 25.000 euro, për Neritan Nallbati.

### **Hetimi administrativ**

✚ **ASHK, DV Vlorë**, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 31.07.2023, nuk konfirmon pasuri të regjistruar në emër të subjektit dhe personave të lidhur.

✚ **Fibank**, me shkresën nr. \*\*\*, prot, datë 8.5.2023, konfirmon shumën e kredituar në datë 24.07.2013, në llogarinë e Neritan Nallbati, prej 25.000 euro, nga Sh. B. me përshkrimin "Shlyerje detyrimi". (Shumë e tërhequr nga llogaria, po në datë 24.07.2013.)

**Në procesverbalin e datës 05.07.2023, dhe me datë, 31.07.2023,** të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit subjekti ka sqarua: *“Burim për blerjen e apartamentit me sip. 56.7 m2, në \*\*\*, Vlorë, kanë shërbyer kursimet e të ardhurave familjare ndër vite. Deri në vitin 2013, shuma e të ardhurave të tij dhe të bashkëshortes ka qenë rreth 11.618.232 lekë”.*

- Lidhur me faktin e mos deklarimit të kursimeve në “Deklaratën e interesave privat të vitit 2004.

**Në procesverbalin e datës 05.07.2023,dhe më datë 31.07.2023,** të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit subjekti ka sqarua: *“Në deklarimin e interesave private të vitit 2004, ka sqaruar se ka qenë lapsus nga ana e tij mos deklarimi i kursimeve, pasi pagat janë publike dhe ILDKPKI ka të gjithë autoritetin dhe autorizimin që ti kontrolloje ato. Nuk ka pasur qëllim të mos i deklarojë, por e ka plotësuar rubrikën në deklaratë, si kuptim i të ardhurave nga burime të tjera dhe jo si të ardhura nga paga.*

*Përsa i përket destinacionit të shumës së tërhequr nga llogaria në datë 24.07.2013, prej 25.000 euro, ka sqaruar se shumën e shitjes së shtëpisë e ka tërhequr pasi vajza e tij Laura Nallbati fitoi studimet për universitet në Gjermani dhe do ti duheshin për të mbuluar disa shpenzime.*

*Se gjatë kësaj periudhe ka pasur kursime të mjaftueshme për akumulimin e shumës për blerjen e shtëpisë në \*\*\*,Vlorë, pasi apartamenti i blerë në vitin 1998 është shlyer pjesë-pjesë deri në vitin 2010 dhe jo e gjithë shuma e kursyer nga pagat deri në atë periudhë.*

*Referuar dokumentacionit të dorëzuar, si dhe përgjigjes së institucionit për pamundësinë e vënies në dispozicion të dokumentacionit të gjithë të ardhurave ndër vite, që nga fillimi i punës dhe deri në vitin 2000, ku thuhet së "nuk janë llogaritur të ardhurat e tjera, si shpërblim, ndihma financiar, letra me vlerë, taksa e solidaritetit, orë suplementare apo do e ardhur tjetër financiar", kjo sipas shkresës nr. \*\*\*, datë 12.02.2021, të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë shkruhet së janë përfshirë vetëm të ardhurat nga paga.*

*Shuma e të ardhurave të tij deri në vitin 1998 ka qenë rreth 2.613.494 lekë, (pa përfshirë këtu të ardhura të tjera nga letrat me vlerë, shpërblimet dhe trajtimet me ushqim në natyrë, apo të ardhura nga shpërblimet e grumbullimit të ardhurave nga të tretë, pasi mungon dokumentacioni, shtuar këtu faktin së nga ky vit e me pas është bërë shlyerja e shtëpisë me këste ndër vite, qëndrimi tek babai i bashkëshortes deri në vitin 2003, ka bërë që të ketë kursime nga të ardhurat e tij nga fillimi i punës deri në vitin 1998 dhe në vazhdim.*

*Sipas përlllogaritjes së bërë nga ana e tij, kjo shumë e këtyre të ardhurave nga viti 1992 deri në vitin 2003, mund të shkojë rreth 800.000 lekë, pra rreth 100.000 lekë në vit, por ketë gjë ai e ka relatuar pavarësisht se nuk ka arritur të gjejë vlerat e sakta. Këto pagesa janë bërë nga institucionet dhe kanë qenë publike prandaj i ka pasqyruar si të ardhura, por nuk i ka vendosur një vlerë. Referuar CV së tij, si dhe vërtetimeve të vëna në dispozicion nga punëdhënësi, nga*

viti 1999 deri në vitin 2003, ka qenë i emërua në detyrë jashtë vendbanimit dhe ka përfituar të ardhura dhe kompensim për ushqim dhe udhëtim, ku të gjitha shpenzimet mbuloheshin nga puna. Kështu që edhe përlllogaritja e shumës së shpenzimeve familjare duhet të jetë e vogël për faktet e paraqitura me lart, pasi familja ka qenë e shpërndarë dhe e trajtuar me burime ekstra të jetesës si të tij, ashtu dhe të bashkëshortes dhe fëmijëve.

Pra lidhur me shpenzimet për frymë, referuar faktit se nga viti 1999 - 2003, për shpenzimet e tij jetike (strehim, ushqim, veshmbathje) është trajtuar nga shteti dhe bashkëshortja e fëmijët kanë ndenjur tek vjehri, ku nga vjehri dhe familjare të tjerë kanë pasur edhe ndonjë ndihmë, atëherë mendon që duhet ti referohemi shpenzimeve për frymë për tre persona dhe jo për 4 persona. Rrjedhimisht edhe shpenzimet për frymë nga viti 2000 - 2012, ku përfshihet dhe blerja e makinës mendon se duhet të jen në një vlerë me të vogël”.

Subjekti ka sqaruar se : “... nuk janë llogaritur shpërblimet për fund viti të citat kanë qenë sa një pagë mujore dhe lejet vjetore dita trajtimi me ushqim për vitet 2000 – 2003, sipas VKM nr. 1247, datë 2.6.2000. Për vitin 2002 dhe 2003, nuk janë llogaritur shpërblimet e fund vitit dhe shpërblimi nga të ardhurat që krijonte policia e shtetit sipas VKM nr. 424, datë 09.07.1998, "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet Bachetore", ku për shkak të pozicionit të punës, ai e përfitonte këtë të ardhur. Kjo ishte sqaruar në përgjigjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Ekonomisë dhe Shërbimeve Mbështetëse .\*\*\*, datë 12.01.2021”. Gjithashtu ka shpjeguar se “..në atë periudhë ka pasur edhe depozitë në Fibank, 3.000.000 lekë kursime familjarë, plus nga Firmat rentjere + Vendimi i Gjykatës”.

Si përfundim të ardhurat e tij nga koha e fillimit të punës dhe deri në vitin 2013, kohë e cila ai ka blerë shtëpinë në " \*\*\*" në Vlorë, kanë qenë të mjaftueshme, dhe ka bërë një përlllogaritje të përafërt:

-Të ardhurat nga fillimi i punës deri në vitin 2013 janë rreth 13.198.232 lekë. Duke zbritur:

-Shlyerjen e shtëpisë ku ai banon, në shumën 1.800.000 lekë,

-Arredimin e shtëpisë ku banon, në shumën 450.000 lekë,

-Blerjen e një automjeti në shumën 500.000 lekë,

-Shumën e të ardhurave të tij dhe të bashkëshortes, nga muaji maj 2013, kohë në të cilën ishte blerë shtëpia në Ujin e Ftohtë, Vlorë, në shumën rreth 498.505 lekë.

- Sa i përket destinacionit të të ardhurave, në shumën 25.000 Euro, nga shitja e apartamentit në \*\*\*, Vlorë, në vitin 2013;

**Në procesverbalin e datës 05.07.2023, dhe më datë 11.07.2023,** të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit subjekti ka sqarua: “Sh. B., me të cilën kanë lidhje krushqie, i duheshin borxh 37.000 euro, të cilat subjekti i dispononte pas shitjes së apartamentit në \*\*\*, Vlorë, në shumën 25.000 euro dhe pjesën tjetër e kishte kursime nga pagat. Kanë hartuar Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* Rep, nr. \*\*\* Kol, datë 27.07.2013 shumë e cila do likuidohej në datë 30.05.2014.

Në gusht 2013 fiton studimet për Gjermani vajza e tij Laura Nallbati, kështu që Sh. B., u detyrua të mos e përdorte shumën e dhënë hua, e cila iu kthye.



*Duke qenë se me Sh. B., janë në marrëdhënie krushqie, nuk përpiluan një Revokim Deklaratë, kjo gjë vërtetohet dhe me faktin, së nga ana e tij, duke qenë para faktit se Sh. B., nuk me ka asnjë detyrim, nuk ka bërë asnjë kërkim për detyrimin e parashikuar në deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 27.07.2013.*

### **Subjekti paraqiti:**

- Deklaratë Noteriale nr. \*\*\* Rep, nr. \*\*\* Kol, datë 10.07.2023, nga Sh. B., ku deklarohet se me Z. Neritan Nallbati, janë në marrëdhënie krushqie dhe së bashku kanë përpiluar deklaratën noteriale nr. \*\*\* Rep, nr. \*\*\* Kol, datë 27.07.2013, me anë të së cilës vërtetohet se deklaruesja i ka marrë hua shumën 37.000 euro, këtë shumë të cilën ja ka kthyer pa e përdorur, pasi në gusht 2013, ka filluar studimet vajza e tij dhe kjo shumë i nevojitet për të mbuluar shpenzimet e qëndrimit dhe studimeve të saj.
- Deklaratë Noteriale nr. \*\*\* Rep, nr. \*\*\* Kol, datë 27.07.2013 dhe ID e Sh. B. dhe Neritan Nallbati.

**Në procesverbalin e datë 31.07.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit, subjekti ka sqarua: *“Referuar sqarimeve të dhëna nga ana e tij, rezulton se shuma totale cash e vitit 2013, ka qenë 37.000 euro gjithsej dhe jo 62.000 euro.*

*Kjo shumë është deklaruar nga ana e tij si e pashlyer në deklaratën e interesave private "Para fillimit të detyrës 2019", pasi e vlerësoi se meqenëse nuk kishte marrë akoma një deklaratë noteriale nga ana e Sh. B., duhej ta raportonte”.*

**Me e-mail-in e datës 05.02.2024**, relatorja e çështjes i ka dërguar subjektit të vlerësimi relacionin paraprak mbi përfundimin kryesisht të hetimit administrative, ku me e-mail-in e datës 08.02.2024, subjekti ka paraqitur objeksionet ku ka sqaruar se: *“Në atë kohë unë kam qenë banor në qytetin e Tiranës dhe duke qenë se ky apartament ndodhej larg, vendosa që tja shes zonjës së sipërcituar, me të cilën kemi marrëdhënie familjare, e cila prej disa kohesh kishte shfaqur dëshirën për ta blerë këtë apartament por që unë nuk mund ta shisja sepse ende edhe vete nuk isha pajisur me dokumentacionin përkatës. Për këtë arsye menjëherë sapo u pajisa me dokumentacionin përkatës, kam kryer edhe kalimin e pronësisë të kjo shtetase, fakt i cili vërtetohet me të dhënat e pasqyruara në këto kontrata shitje, ku konstatohet se veprimet e blerjes dhe shitjes së shpejt të kësaj pasurie.*

*Fakti që kjo pasuri është në pronësi të kësaj shtetase, që posedohet dhe përdoret nga kjo shtetase dhe familjaret e saj, vërtetohet plotësisht me librezat e ujit dhe të dritave, të cilat rezultojnë të jenë në emër të kësaj shtetase, fakt i cili provohet lehtësisht me anë të dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe të marre në shqyrtim nga ana Juaj.*

*Gjithashtu rezulton se znj. Sh. B. dhe bashkëshorti i saj E. Sh. kanë aktivitet tregtare të cilin e ushtrojnë me subjektet tregtare të pajisura me Nipt \*\*\*, dhe \*\*\*, dhe për nevoja të biznesit të tyre, me kane kërkuar ndihmë për të dhënë hua dhe për këtë arsye i kam ndihmuar duke i dhënë një shumë rreth 37.000 euro (të ardhura të krijuara nga shitja e apartamentit në \*\*\*, Vlorë, dhe pjesa tjetër nga kursimet nga pagat). Ky fakt pasqyrohet në Deklaratën Noteriale nr. \*\*\*, Rep, nr. \*\*\*, Kol, datë 27.07.2013 dhe kjo shumë do të kthehej në datë 30.05.2014.*

*Ndërkohe rezulton se në muajin gusht të vitin 2013, jemi njoftuar , pas aplikimit të bërë, se vaja ime Laura Nallbati ka fituar të drejtën për kryerjen e studimeve në Gjermani dhe për këtë arsye kam komunikuar me znj.Sh.B, duke i thënë se vajza kishte fituar të drejtën e studimeve në Gjermani dhe se e kish atë nevojshme dhe të domosdoshme kishin e shumes se dhënë hua sepse duhet të paguaja detyrimet monetare, të cilat ishin të nevojshme dhe të domosdoshme për ti dhënë mundësi vajzës time të kryente studimet.*

*Znj. Sh. B. me mirëkuptoi dhe me ktheu shumën e marrë hua dhe duke qenë se jemi në marrëdhënie krushqie, shpjegoj se nuk kemi përpiluar një akt noterial për revokim të Deklaratës Noteriale nr.\*\*\* Rep, nr.\*\*\* Kol, datë 27.07.2013, apo të një deklaratë ku të citohej kthimi i shumës dhe marrëdhënia jonë ka vazhduar normal dhe në asnjë moment nuk rezulton që kjo shtetase të këtë patur detyrime ndaj meje dhe unë nuk ka bërë asnjë kërkim për detyrimin e parashikuar në deklaratën noteriale nr.\*\*\*Rep, nr.\*\*\*Kol, datë 27.07.2013;*

*Në bazë të Deklaratës Noteriale nr. \*\*\* Rep, nr. \*\*\* Kol, datë 10.07.2023, rezulton se znj. Sh.B. Deklaron se me Z. Neritan Nallbati, janë në marrëdhënie familjare / krushqie dhe së bashku kanë përpiluar deklaratën noteriale nr. \*\*\* Rep, nr. \*\*\* Kol, datë 27.07.2013, me anë të së cilës vërtetohet se deklaruesja i ka marrë hua shumën 37.000 euro, këtë shumë të cilën ja ka kthyer pa e përdorur, pasi në gusht 2013, ka filluar studimet vajza e tij dhe kjo shumë i nevojitet për të mbuluar shpenzimet e qëndrimit dhe studimeve të saj.*

*Gjithashtu vlen të theksohet dhe fakti që unë në këtë periudhe nuk kam pasur asnjë funksion publik për të pasur ndalesa qoftë për pagesat në kesh apo dhe për faktin se me subjektet me të cilat kam kryer transaksionet nuk gjendesha në kushtet e konfliktit të interesit”.*

### **Subjekti paraqiti:**

- Dokumentacion për vërtetimin e burimit të ligjshëm për krijimin e pasurisë nga shtetësia Sh.B.

### **Konkluzion:**

- ✓ Apartamenti me sip. 56.7 m2, në \*\*\*, Vlorë, është blerë nga subjekti me kontratë blerje në vitin 2013, në shumën 3.419.010 lekë, me burim kursime familjare dhe është shitur po në vitin 2013, me kontratë shitje në shumën 25.000 euro. Sipas sqarimeve të subjektit, kjo shumë, si dhe kursime të subjektit në shumën 12.000 Euro, i janë dhënë hua shtetases Sh. B., e cila i ka kthyer në një afat të shkurtër kohor, të papërdorura.
- ✓ Subjekti ka dhënë sqarime lidhur me apartamentin me sip. 56.7 m2, në \*\*\*, Vlorë dhe burimin financiar të përdorur për blerjen e tij, në periudhën deri në vitin 2013. Ky apartament është shitur po në vitin 2013.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar, lidhur me pronësinë e apartamentit me sip. 56.7 m2, në \*\*\*, Vlorë.

### **Pasuria nr. 4**

Truall, Zona Kadastra Nr. 3177, Nr. pasurie në \*\*\*, 160 m2, ndërtesë e pabanuar 42.9 m2, në \*\*\*, Tepelenë. Vlera 10.500 lekë. Vetëm pagesa e aplikimit.

**Burimi i krijimit:** Të kësaj pasurie është me vendim nr.58 datë 26.11.2021, për kalim pronësie nga ASHK. Pjesë takuese 50%

### Hetimi administrativ

✚ **ASHK, Drejtoria e Përgjithshme**, me shkresën nr. \*\*\*, datë 12.06.2023, konfirmon se Nertina (pa atësi) Nallbati, figuron vetdeklarues me formularin nr. prot. 1985, objekt para 1991, Tepelenë.

✚ **ASHK, DV Tepelenë**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 06.07.2023, konfirmon pasurinë nr. \*\*\*, , Zk \*\*\*, me sip. 160 m2, truall dhe 42.9 m2 shtëpi përpara vitit 1991, përfituar me vendimin nr. 112, datë 16.6.2022, në emër të Neritan Nallbati dhe Nertina Nallbati. Bashkëlidhur;

- Kërkesë për kalim pronësi të objektit pa titull/truallit funksional/oborrit në përdorim, nr. \*\*\* prot, datë 26.08.2022, nga Nertina Nallbati, me adresë \*\*\*, Tepelenë.
- Foto të shtëpisë, si dhe truallit rreth saj (gjithsej 17 fletë)
- Akt Konstatimi nr. \*\*\*, datë 27.08.2021, nga ASHK, DV Tepelenë.
- Kartela e pasurisë së paluajtshme nr. pasurie \*\*\*ZK\*\*\*, "arë" me sip. totale 2.327m2, në pronësinë "shtet".
- Njoftim për mbyllje të afishimit publik, nr. \*\*\*prot., datë 06.10.2021, nga Bashkia Tepelenë, për pasurinë nr. \*\*\* ZK. \*\*\*, në \*\*\*, objekti godinë banimi, një kat me sip. ndërtimi 42.9 m2 dhe truall funksional 160 m2, në pronësi të Nertina Nallbati.
- Përcjellje dokumentacioni për afishim pasurie nga ASHK, DV Tepelenë nr. \*\*\* prot, datë 06.10.2021.
- Njoftim mbi afishimin publik të pasurive nr. \*\*\*prot, datë 06.10.2021. Dërgimi për regjistrim në Sektorin e Hipotekës, të Vendimit nr. \*\*\*, datë 26.11.2021.
- Vendim nr. \*\*\* datë 26.11.2021, për miratimin e kërkesës për kalimin në pronësi të objektit pa titull pronësi me truall funksional, në emër të Nertina Nallbati, për pasurinë nr. \*\*\*, ZK \*\*\*, me sip. ndërtimi 42.9 m2 dhe sip. trualli funksional 160 m2.
- Certifikatë regjistrimi pronësi, për pasurinë nr. \*\*\*, ZK \*\*\*, truall me sip. 160m2, nga e cila ndërtesë me sip. 42.9 m2 në emër të Nertina Nallbati dhe Neritan Nallbati + kartela e pasurisë së paluajtshme.

**Në procesverbalin e datës 05.07.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit, subjekti ka sqarua: *“Se kjo pasuri është përfituar nga kërkesa e bashkëshortes së tij Nertina Nallbati në ASHK Tepelenë, për kalimin e pronësisë pa titull pronësi, dorëzuar në datën \*\*\*, në Zyrën Vendore të ASHK Tepelenë. Kërkesa është bërë si ish banore e kësaj zone, nga babai i saj, Bashkëlidhur:*

- *Kërkesë për kalim pronësi të objektit pa titull/truall funksional/ oborr në përdorim, nr. \*\*\* prot. datë 26.08.2021, nga Nertina Nallbati, me adresë \*\*\*, Tepelenë.*
- *Mandat pagesë datë 01.06.2022, për ZVRPP Tepelenë e shumës 10.600 lekë.*

- Përcjellje dokumentacioni për afishim pasurie nga ASHK, DV Tepelenë nr. \*\*\* prot, datë 06.10.2021.
- Njoftim mbi afishimin publik të pasurive nr. \*\*\*prot, datë 06.10.2021 .
- Njoftim për mbyllje afishimi publik nr. \*\*\*prot, datë 22.11.2021, nga Bashkia Tepelenë, për pasurinë nr. \*\*\*, ZK. \*\*\*, fshati \*\*\*, objekti godinë banimi, një kat sip. 42.9m2 dhe truall funksional 160 m2, në pronësi të znj. Nertina Nallbati.
- Dërgim për regjistrim në Sektorin e Hipotekës, të vendimit nr. \*\*\*, datë 26.11.2021.
- Planimetri Foto të shtëpisë, si dhe truallit rreth saj (Gjithsej 18 fletë).
- Akt Konstatimi nr. \*\*\*, datë 27.08.2021, nga AHK, DV Tepelenë.
- Vendim nr. \*\*\*, datë \*\*\*, për miratimin e kërkesës për kalim në pronësi të objektit pa titull pronësi me truall funksional, në emër të Nertina Nallbati, për pasurinë nr. \*\*\*, ZK. \*\*\*, me sip. ndërtimi 42.9 m2 dhe sip. Trualli funksional. 160 m2.
- Kartelë e pasurisë së paluajtshme nr. pasurie \*\*\* ZK. \*\*\* "arë" me sip. Totale 2.327 m2, në pronësinë "shtet"+ Gent plan.

**Në procesverbalin e datë 05.07.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit subjekti ka sqarua: "Kjo pasuri është përfituar nga kërkesa e bashkëshortes së tij Nertina Nallbati në ASHK Tepelenë, për kalimin e pronësisë pa titull pronësi, dorëzuar në Zyrën Vendore të ASHK Tepelenë.

Për këtë fakt ka paraqitur të gjithë praktikën e përfitimit të këtij aseti, që nga kërkesa, mandati i pagesës prej 10.600 lekë, përcjellje e dokumentacionit për afishim publik nr. \*\*\*, datë 06.10.2021, njoftimi për afishim publik nr. \*\*\*, datë 06.10.2021, Vendimi nr. \*\*\*, datë 26.11.2021 dhe certifikata e pronësisë, dokumentacioni i marrë nga ASHK.

Gjithashtu ka sqaruar se, referuar certifikatës së trungut familjar të marrë nga Zyra e gjendjes civile (arkiva) e fshatit \*\*\*, Tepelenë, vërtetohet së babai i bashkëshortes ka lindur dhe ka jetuar për një periudhë në fshatin \*\*\*, Tepelenë. Ligji 20/20 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" në vetvete trajton të gjithë ata pronarë të cilët nuk kanë pasur mundësi të sigurojnë dokumentacionin e fitimit të pronësisë. Referuar dokumentacionit ligjor, certifikimi i pronësisë është bërë me shpallje publike, sipas shkresës nr. \*\*\*, datë \*\*\*, që nëse shteti apo një person i tret të kishte ndonjë pretendim lidhur me pronësinë, bënte të mundur që ASHK Tepelenë të mos certifikonte pronën.

Babai i bashkëshortes është gjallë dhe nuk ka bërë ai kërkesë për fitimin e kësaj pronësi, pasi ai nuk e quajti me interes këtë gjë, duke qenë së është në moshë të thyer. Gjithashtu edhe kërkesa e bërë nga ana e bashkëshortes u bë pasi informacionit në Zyrën Vendore të regjistrimit të pasurive në Tepelenë dhe pas konfirmimit të tyre së ishte e ligjshme kërkesa, ajo u depozitua. Për këtë është bërë edhe njoftimi publik sipas ligjit, për çdo lloj kontestimi që mund të kishte, dhe me pas është marrë vendimi i fitimit të pronësisë për kalimin e pronësisë pa titull pronësi.

### **Subjekti paraqiti:**

- Kërkesë datë 27.07.2023, drejtuar Zyrës së Kadastrës Tepelenë, për vëni në dispozicion të një dokumenti që tregon së babai i bashkëshortes, ka lindur dhe jetuar në fshatin \*\*\*, Tepelenë dhe nëse familja e tij ka pasur pronësi në këtë fshat.
- Certifikatë familjare, datë 26.07.2023, nga Zyra e Gjendjes Civile \*\*\*, me kryefamiljar T. I., i përbërë nga 6 anëtar, nder ta edhe R. I. (babai i bashkëshortes).

- Lista e pronësisë së tokës, nga Zyra e Kadastrës Tepelenë. Numër i listës së pronësisë \*\*\* katundi ,kadastra; \*\*\*, Tepelenë, në emër të T. I.

**Konkluzion:**

- ✓ Trualli me sip. 160 m2 dhe ndërtesa e pabanuar me sip. 42.9 m2, në fshatin \*\*\*,Tepelenë, në zotërim 100% të subjektit dhe bashkëshortes së tij, është regjistruar në bazë të Vendimi nr. \*\*\*, datë 26.11.2021 të ASHK DV Tepelenë, për miratimin e kërkesës për kalimin në pronësi të objektit pa titull pronësi me truall funksional. Vlera e paguar është 10.500 lekë. Kërkesa është bërë me cilësinë e një ish banori të fshatit nga babai i saj.
- ✓ Subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me truallin me sip.160 m2 dhe ndërtesën e pabanuar me sip.42.9 m2, në fshatin \*\*\* Tepelenë dhe cilësinë mbi të cilën është bërë kërkesa për regjistrim në vitin \*\*\*.
- ✓ Konfirmohet nga ASHK pronësia e subjektit dhe bashkëshortes së tij në këtë pasuri.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorësuar.

**Pasuria nr. 5.**

Gjendje në llogarinë rrjedhëse në lekë në emër të Neritan Nallbati Union Bank, deri në datë 21.02.2023, shuma 441.225 lekë.

**Burimi i krijimit:** Të ardhura nga paga. Pjesë takuese 100%.

**Bashkëlidhur deklaratës:**

- Nxjerrje llogarie nga Union Bank në emër të Neritan Nallbati, për periudhën 24.10.2017 - 21.2.2023. Konfirmohet gjendja e llogarisë në datë 21.2.2023, në shumën 441.225 lekë.

**Hetimi administrativ**

🚩 **Union Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 26.05.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të Neritan Nallbati, me balancë në datë 09.03.2023, shumën 440.145 lekë.

**Konkluzion:**

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorësuar dhe përgjigjen e Union Bank.

**Pasuria nr. 6**

Gjendje në llogarinë rrjedhëse në Euro në emër të Neritan Nallbati Union Bank, deri në datë 21.2.2023, shuma 30.02 Euro.

**Burimi i krijimit:** Të ardhura nga paga. Pjesë takuese 100%.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

Nxjerrje llogarie nga Union Bank në emër të Neritan Nallbati, për periudhën 10.07.2020 - 21.02.2023. Konfirmohet gjendja e llogarisë në datë 21.02.2023, në shumën 30 euro.

### **Hetimi administrativ**

✚ **Union Bank**, me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 26.05.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të Neritan Nallbati në monedhën euro, me balancë në datë 09.03.2023 shumën 20.52 Euro.

### **Konkluzion:**

✓ Konfirmohet deklarami me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Union Bank.

### **Pasuria nr. 7.**

Gjendje në llogarinë rrjedhëse në lekë, në emër të Neritan Nallbati në Raiffeisen Bank, deri në datë 21.02.2023 shuma 2.241.547 lekë.

**Burimi i krijimit:** Të ardhura nga paga. Pjesë takuese 100%

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Banke, në emër të Neritan Nallbati, për periudhën 14.10.2013 - 21.02.2023. Konfirmohet gjendja e llogarisë në datë 21.2.2023, në shumën 2.241.547 Lekë.

### **Hetimi administrativ**

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 08.05.2023, konfirmon llogari pagë në emër të Neritan Nallbati, me balancë në datë 09.03.2023, shumën 2.277.710 lekë.

### **Konkluzion:**

✓ Konfirmohet deklarami me dokumentacionin e dorëzuar. Sipas Raiffeisen Bank, gjendje në datë 09.03.2023 është 2.277.710 lekë.

### **Pasuria nr. 8.**

Gjendje në llogarinë rrjedhëse në euro në emër të Neritan Nallbati, në Raiffeisen Bank, deri në datë 21.02.2023, shuma 146.17 Euro.

**Burimi i krijimit:** Të ardhura nga paga. Pjesë takuese 100%

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bankë emër të Neritan Nallbati, për periudhën 10.4.2012 - 21.2.2023.

### **Hetimi administrativ**

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 08.05.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të Neritan Nallbati, me balancë në datë 09.03.2023, shumën 146 euro.

### **Konkluzion:**

✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank.

### **Pasuria nr. 9.**

Gjendje cash shuma 210.000 lekë.

**Burimi i krijimit:** Nga shitja e makinës Nissan Micra 200.000 lekë dhe 10.000 lekë nga gjendja cash e një viti me parë. Zotëron 100%.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë Shitje automjeti nr. \*\*\* Rep, nr.\*\*\* Kol, datë 25.11.2022. Automjet Nissan Micra, nr. shasie \*\*\*\*\*, me targë A\*\*\*LY, në shumën 200.000 lekë, Palë shitëse Neritan Nallbati.

- Nxjerrje llogarie nga Credins Bank datë 24.02.2023, në emër të Nertina Nallbati.

Konfirmohet kreditimi i shumës 200.000 lekë, në datë 30.11.2022, për shitjen e automjetit sipas Kontratës nr.\*\*\* Rep, nr.\*\*\* Kol, datë 25.11.2022.

### **Hetimi administrativ**

✚ **Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 15.05.2023, konfirmon kreditimin e shumës 200.000 lekë, në datë 30.11.2022, për shitje automjeti, sipas Kontratës nr. \*\*\* Rep, nr. \*\*\* Kol, datë 25.11.2022.

### **Konstatohet;**

- ✓ Gjendja cash është krijuar gjatë periudhës 2021 - 2022.
- ✓ Të ardhurat e realizuara justifikoni gjendjen cash të deklaruar.

## DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

### Subjekti vlerësues Neritan Nallbati ka dhënë këto deklaratime të ardhurave në vite:

- Të ardhura nga paga, e Neritan Nallbati për periudhën nga momenti i titullimit oficer në datën 01.10.1991 deri në datë 29.02.1992, rreth 7.350 lekë.
- Të ardhura nga paga, orë suplementare dhe shpërblime të Neritan Nallbati për periudhën nga data 01.03.1992 deri në 31.12.1993, në Drejtorinë e Policisë së Tiranës, rreth 144.000 lekë.
- Të ardhura nga paga dhe shpërblime e Neritan Nallbati për periudhën nga data 01.01.1994 deri me 31.12.1999, në Drejtorinë e Policisë së Tiranës, rreth 954.600 lekë.
- Të ardhura nga orë suplementare dhe shpërblimet nga të ardhurat e krijuara nga institucioni, të Neritan Nallbati, për periudhën nga data 01.01.1994 deri me 31.12.1999, në Drejtorinë e Policisë së Tiranës, rreth 700.000 lekë.
- Të ardhura nga firmat rentjere, "\*\*\*\*" dhe "\*\*\*\*", për periudhën janar 1995 deri në dhjetor 1996, shuma 800.000 lekë.
- Të ardhura nga paga dhe shpërblime e Neritan Nallbati por periudhën nga data 01.01.2000 deri me 01.02.2001, në Ministrinë e Brendshme, në shumën 350.000 lekë.
- Të ardhura nga paga dhe shpërblime e Neritan Nallbati për periudhën nga data 01.02.2001 deri në 21.04.2002, në Drejtorinë e Policisë Elbasan, 317.338 lekë.
- Të ardhura nga taksa e solidaritetit për periudhën 01.04.1997 deri në 31.12.2001, rreth 670.000 lekë.
- Të ardhura nga paga dhe shpërblime e Neritan Nallbati për periudhën nga data 22.04.2002 deri me 21.07.2003, në Drejtorinë e Policisë Vlorë, rreth 902.447 lekë.
- Të ardhura nga paga dhe shpërblime e Neritan Nallbati për periudhën nga data 22.07.2003 deri në 21.11.2003, në Drejtorinë e Policisë Elbasan, në shumën 256.375 lekë.
- Të ardhura nga paga e Neritan Nallbati për periudhën nga data 02.04.2004 deri në 31.01.2005, në firmën \*\*\*, shumën 360.000 lekë.
- Të ardhura nga zbatimi i vendimit të gjykatës i fituar nga Neritan Nallbati, ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, në shumën 632.363 lekë.
- Të ardhura nga paga e Neritan Nallbati për periudhën nga data 01.04.2010 deri në 31.11.2013, në firmën "\*\*\*\*" sh.p.k, shuma 721.064 lekë.
- Të ardhura nga paga dhe shpërblime e Neritan Nallbati në Policinë e Shtetit, nga data 09.10.2013 deri aktualisht 13.080.632 lekë.
- Gjendje cash, deri në datën 21.02,2023, në shumën 210.000 lekë. Burimi i krijimit: Nga shitja e makinës Nisan Micra 200.000 lekë dhe 10.000 lekë nga gjendja cash e një viti më parë.
- Të ardhura nga paga e Neritan Nallbati në mësimdhënie në \*\*\* për periudhën 06.10.2017 deri aktualisht, në shumën 5.224.500 lekë.
- Të ardhura nga bursa për Laura Nallbati për periudhën 2007 - 2012, në shumën 153.000 lekë.
- Të ardhura nga bursa për Levia Nallbati për periudhën 2014 - 2019, në shumën 54.000 lekë.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**



- Fletë nga regjistri, me të dhënat se ku ka studiuar dhe punuar subjekti, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Konfirmohen marrëdhëniet e punës për periudhën 01.03.1992 - 22.11.2003 dhe 09.10.2013 e në vazhdim.
- Kthim përgjigje nr. \*\*\* prot, drejtuar Neritan Nallbati, ku është bashkëlidhur dokumentacioni mbi orët suplementare të përfituara gatë periudhës 01.03.1992 - 01.08.1998.
- Urdhër i Ministrit të Rendit Publik nr. \*\*\*, datë 02.06.2000 "Për trajtimin me ushqim të efektivit të Aparatit të M.R. Publik dhe atij që trajnohet në Qendrën e Trajnimit Durrës".
- Relacion mbi Projekt- Urdhrin "Për trajtimin me ushqim të efektivit të Aparatit të M.R. Publik dhe atij që trajnohet në Qendrën e Trajnimit Durrës".
- Urdhër i Ministrit të Rendit Publik nr. \*\*\*, datë 17.07.2000 "Për një shtesë në urdhrin e Ministrit të Rendit Publik nr. \*\*\*, datë 11.08.1999 "Për trajtimin me ushqim të ushtarakëve aktive të përhershëm në sistemin e M. R. Publik".
- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, në emër të Neritan Nallbati, për periudhën 14.10.2013 - 21.02.2023. Konfirmohen të ardhurat nga paga, shpërblime, uniformë ahë telefon, për periudhën tetor 2013 - janar 2023.
- Nxjerrje llogarie nga Union Bank, në emër të Neritan Nallbati, për periudhën 24.10.2017 - 21.02.2023. Konfirmohen të ardhurat nga \*\*\* dhe \*\*\*, për periudhën tetor - dhjetor 2017 dhe mars -shtator 2022, në shumën totale 4.994.850 lekë.
- Nxjerrje llogarie në monedhën Euro, nga Raiffeisen Bank, në emër të Neritan Nallbati, për periudhën 10.04.2012 - 21.02.2023, Konfirmohen të ardhura nga likuidim demi në datë 02.05.2012, në shumën 1.429 euro dhe nga OSBE në datë 09.01.2020, në shumën 490 euro (total 1.919 Euro).
- Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank në emër të Neritan Nallbati, ku konfirmohet kreditimi i pagës për periudhën janar -shkurt 2019, në shumën totale 216.300 lekë.

### Hetimi administrativ

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 08.05.2023, konfirmon të ardhurat nga paga, shpërblime, veshje, kompensim telefoni, veshje etj., për Neritan Nallbati, për periudhën tetor 2013 - shkurt 2023, në shumën totale rreth 13.366.803 lekë.

✚ **BKT**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 09.05.2023, konfirmon të ardhurat nga paga, për Neritan Nallbati, nga \*\*\*ShPK, për periudhën tetor 2010 - tetor 2013, në shumën totale rreth 621.660 lekë.

✚ **Tirana Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 12.05.2023, konfirmon të ardhurat nga paga për Neritan Nallbati, për periudhën janar 2018 - shkurt 2019, në shumën 1.555.350 lekë.

✚ **Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 15.05.2023, konfirmon të ardhurat nga paga për Neritan Nallbati, për periudhën prill 2014 - shkurt 2023, në shumën totale 6.160.949 lekë.

Të ardhura nga bursa për Laura Nallbati për periudhën 2007 - 2012, në shumën 153.000 lekë.

Të ardhura nga bursa për Levia Nallbati për periudhën 2014 - 2019, në shumën 54.000 lekë.

✚ **Union Bank**, me shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 26.05.2023, konfirmon të ardhurat për Neritan Nallbati nga \*\*\*\*, për periudhën tetor 2017 - shtator 2022, në shumën totale 4.994.850 lekë.

✚ **ISSH**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 12.05.2023, konfirmon kontributet e derdhura për Neritan Nallbati për periudhën janar 2012 - tetor 2013, nga \*\*\*, shkurt 2012- prill 2015, nga Drejtoria e Policisë Elbasan, prill 2015 - mars 2023 nga DVP Policisë Fier, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, DV Policisë Berat, DV e Policisë Durrës dhe për periudhën tetor 2017 - tetor 2022 nga \*\*\*\* dhe \*\*\*\* .

- Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank në emër të Neritan Nallbati, ku konfirmohet kreditimi i pagës për periudhën janar -shkurt 2019, në shumën totale 216.300 lekë.

✚ **ISSH, Dritoria e Arkivit Qendror**, me shkresën nr. \*\*\*, prot., datë 17.05.2023, konfirmon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave për periudhën 1994 - 2012, të punonjësve të siguruar në subjektet juridike apo fizike, nuk mund të konfirmon periudhën e kontributeve apo paga mbi të cilën janë siguruar në qoftë se nuk jepen emërtimi i gjëndrës së punës, Nipit i subjektit, fotokopje e librezës së punës. Bashkëlidhur Vërtetim për vjetërsi në pune, për efekt pensioni, nr. \*\*\* prot, datë 15.05.2023, ku konfirmohet fillimi i marrëdhënieve të punës për Neritan Nallbati, në datë 11.11.1987.

**Në procesverbalin e datë 05.07.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit subjekti ka sqarua: *“Për periudhën 2005 - prill 2010, nuk ka qenë i punësuar. Nga muaji prill 2010 e deri në tetor 2013, ka vënë në dispozicion vërtetimin e marrë nga punëdhënësi "\*\*\*\*" ShPK. dhe përsa i përket problematikës të pagesës së sigurimeve shoqërore nga dy institucione, nga \*\*\* ShPK. dhe Drejtoria e Policisë Elbasan, ka sqaruar se pas mbarimit të procesit gjyqësor për vjetërsinë e punës në Policinë e Shtetit, me vendim nr. \*\*\*, datë 22.01.2019, Drejtoria e Policisë Elbasan është detyruar t'i njohë dhe derdh sigurimet shoqërore nga viti -2003 deri në tetor të vitit 2013, periudhë kjo që ka qenë jashtë Policisë së Shtetit, pra gjatë kësaj periudhë nuk ka qenë i dy punësuar.*

*Në lidhje me të ardhurat nga mësimdhënia, ka sqaruar se sipas Ligjit nr. 108/2014, për Policinë e Shtetit, ku punonjësve ju lejohet dy punësimi në mësimdhënie, ka bërë kërkesë në Policinë e Shtetit dhe pas marrjes së dakortësisë ka nënshkruar kontratën me Institucionin arsimor "\*\*\*\*".*

*Paga kreditohej në Tirana bank për një periudhë dhe tek Union Bank për një periudhë tjetër, sipas dakortësisë me institucionin arsimor kreditues të pagës, për këtë ka paraqitur statement të kreditimit të pagës në Tirana Bank dhe Union Bank.*

*Në lidhje me mos deklarimin e saktë të të ardhurave nga mësimdhënia, ka sqaruar se ka bërë një llogaritje aritmetike nga statementet bankare dhe mund të këtë bërë gabim mbledhjen e tyre, por shuma e saktë është ajo që japin institucionet bankare. Për këtë marrëdhënie punësimi është vënë në dijeni dhe është marrë leje nga Policia e Shtetit kundrejt kërkesës dhe paraqitjes së dokumentacionit.*

**Subjekti ka paraqitur:**

- Tabela e të ardhurave, për Neritan Nallbati, Nertina Nallbati, Laura Nallbati dhe Levia Nallbati, përgatitur nga vet subjekti.
- Fletë nga regjistri, me të dhënat se ku ka studiuar dhe punuar subjekti, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Konfirmohen marrëdhëniet e punës për periudhën 01.03.1992 - 22.11.2003 dhe 09.10.2013 e në vazhdim. Ka sqaruar se sipas këtij dokumenti, rezulton se paga mujore, për periudhën 01.03.1992 - 01.08.1993, ka qenë në shumën 3.800 lekë dhe të ardhurat në total janë 64.600 lekë. (para dhe pas kësaj datë ka vërtetim page)
- Curriculum Vital për Neritan Nallbati, ku është pasqyruar historiku i gradave dhe karriera profesionale në pune.
- Kthim përgjigje nr. \*\*\* prot, datë 21.01.2021, nga Akademia e Sigurisë, ku konfirmohen të ardhurat për Neritan Nallbati, për periudhën 01.10.1991 - 28.02.1992, në shumën totale 7.310 lekë.
- Kthim përgjigje nga Ministria e Brendshme, nr. \*\*\* prot, datë 12.01.2021, ku konfirmohet se për periudhën 05.10.1991 - 09.03.1992, mungon informacioni për të ardhurat e pagës dhe për periudhën 1999 - 2001, informacioni është përcjellë me herët. Gjithashtu mungon informacioni për të ardhurat e tjera, si shpërblimet, ndihma financiar, letra me vërë, përfitime taksa e solidaritetit, orë suplementare apo çdo e ardhur tjetër financiar, pasi Aparati i Ministrisë së Brendshme nuk disponon listë-pagesat për periudhën e kërkuar.
- Kthim përgjigje nr. \*\*\* prot, datë 12.02.2021, nga DPPSH. Konfirmohen të ardhurat nga pagat, shpërblimet, orët shtesë dhe taksa e solidaritetit, për periudhën 01.09.1993 - 31.12.1999, në shumën totale 1.529.372 lekë. (Nga të cilat në vitet 1998 - 1999; Orë suplementare në shumën 154.867 lekë, shpërblime në shumën 288.360 lekë dhe taksë solidariteti në vitin 1999, në shumën 120.910 lekë)
- Kthim përgjigje nga Komisariati i Policisë nr. 3, Tiranë, nr. \*\*\* prot, datë 12.10.2022, ku është dërguar informacioni, për orët suplementare, shpërblime, ndihmë financiar, etj., për vitet 1992 - 1998. Sipas dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se Neritan Nallbati ka përfituar për vitin 1996, orë suplementare gjithsej 364 orë + shpërblim një page bazë mujore + pagesën për 3 ditë festa zyrtare. Për vitin 1998 ka përfituar 152 orë suplementare për muajin shtator -tetor 1998. (Nuk janë llogaritur në shumën totale të të ardhurave, për mungesë të dhënash financiar).
- Urdhër nr. 83, datë 09.03.1997, i Komandantit të Shtabit të Gjendjes së Jashtëzakonshme, për trajtim financiar të të gjithë ushtarakëve, për dhënien e një shpërblimi të menjëhershëm me masë 1 page mujore. (paga mujore në atë periudhë, sipas fletës së regjistrimit, ka qenë rreth 9.078 lekë)
- Vendim nr.19, datë 11.01.1993, nga Këshilli i Ministrave, për fondin e veçantë në Institucionet Buxhetorë, ku është vendosur se masa e shpërblimit për çdo punonjës, të jetë jo me shumë se 20% e pagës bazë vjetore dhe të interesave mbi pagën e punonjësve. (Sipas fletës së regjistrimit, paga mujore në vitin 1993 ka qenë 3.800 lekë)
- Urdhër i Ministrit të Brendshëm nr. 7/39, datë 16.04.1997, për shpërblimin e punonjësve, ku titullarët e Kom. Policisë, Gardës, Rep. N. Shpejt, Rep. nr. 324, Drejtorisë së Policisë Tiranë, titullari dhe zëvendësit e tij në Ministri, trajtohen me koeficientin maksimal. Bashkëlidhur shkresa nr. 7/41 e Ministrisë së Brendshme datë 21.04.1997, ku sqarohet se koeficienti maksimal i shpërblimit është 2 ose sa dyfishi i pagës, për periudhën përkatëse.
- Urdhër nr. 7/96, datë 13.05.1997, i Ministrit të Brendshëm, për trajtimin me shpërblim të punonjësve të sistemit të Ministrisë së Brendshme. Trajtimi me shpërblim i strukturave dhe funksioneve organike në repartet e F.Sh.N. dhe Pol. Gatshme, ku shef shtabi, shef përgatitja, shef stërvitje, specialistë të përgatitjes, komandant nënreparti, komandant grupi, instruktor, komandant nëngrupi, komandant toge, trupë (speciale e shërbimi), do trajtohen deri në 200 % të pagës. (Sipas shkresës N-4/1 prot, datë 12.02.2021, të DPPSH, paga

- mujore në prill - maj 1997 ka qenë rreth 10.679 lekë. Si rrjedhojë rezulton shërbimi në shumën 21.358 lekë)
- Shkrese nr. 2023/1 prot, datë 22.03.1998, nga Komisariati i Policisë nr.3, Tiranë, në lidhje me pagesën e orëve suplementare.
  - Vendim nr. 424, datë 09.07.1998, i Këshillit të Ministrave, për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetorë, ku ndër të tjera është vendosur shërbimi i punonjësve jo me shumë se dy paga mujore në vit. (Sipas shkresës N-4/1 prot, datë 12.02.2021, të DPPSH, paga mujore në gusht 1998 ka qenë rreth 20.512 lekë. Si rrjedhojë rezulton shpërblimi në shumën rreth 41.024 lekë)
  - Urdhër 7/448, datë 26.11.1998, nga Ministria e Rendit Publik, për trajtimin me shpërblim të funksioneve organike ushtarake, në sistemin e Ministrisë së Rendit Publik, ku në pikën 2, theksohet se ky shërbim i përcaktuar me këtë urdhër jepet me listë pagesë të veçantë, për çdo muaj, në datë 18 të muajit pasardhës.
  - Urdhër nr.35, datë 15.03.1999, nga Ministria e Rendit Publik për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr. 7/448, datë 26.11.1998.
  - Udhëzim nr. 167, datë 16.10.1999 nga Ministria e Rendit Publik, për trajtimin me shpërblime dhe ndihma të menjëhershme të punonjësve në sistemin e Ministrisë së Rendit Publik.
  - Urdhër nr.25, datë 15.02.1999, nga Ministria e Rendit Publik, për caktimin e masës së shërbimit që do të përcaktohet nga Taksa e Solidaritetit. Bashkëlidhur Urdhër 25/1, datë 15.03.1999 - 25/6, datë 14.08.1999, 25/9, datë 15.11.1999 dhe 25/11, datë 30.12.1999, për një ndryshim në Urdhrin nr. 25, datë 15.02. 1999.
  - Kthim përgjigje nga DPPSH nr. N-3/1 prot, datë 28.01.2021, ku është bashkëlidhur dokumentacioni financiar nga taka e solidaritetit, për periudhën janar –dhjetor 2000. Shuma e përfituar nga Neritan Nallbati në total rreth 128.485 lekë. Bashkëlidhur Urdhër nr. 30/1, datë 16.03.2000 - 30/5, datë 19.07.2000, Urdhër nr. 15, datë 18.08.2000 dhe Urdhër nr. 30/6, datë 19.09.2000, nga Ministria e Rendit Publik, për përcaktimin e nivelit të shërbimit nga taksa e solidaritetit.
  - Urdhër nr. 25/1, datë 18.02.2000, nga Ministria e Rendit Publik, për disa ndryshime në klasifikimin për efekt të trajtimit me page bazë dhe shtesë, për vështirësi shërbimi të disa funksioneve organike ushtarake, në strukturat e sistemit të Ministrisë së Rendit Publik.
  - Urdhër i Ministrit të Rendit Publik, nr. 1247, datë 02.06.2000, për trajtim me ushqim të efektivit të aparatit të M. R. Publik dhe atij që trajtohet në Qendrën e Trajtimit Durrës.
  - Kthim përgjigje nga Ministria e Brendshme nr.382/1 prot, datë 03.02.2021, ku konfirmohen të ardhurat nga paga për Neritan Nallbati, për periudhën 01.01.2000 - 01.02.2001, në shumën totale rreth 262.174 lekë.
  - Kthim përgjigje nga DV Policisë Elbasan, nr. 436/1 prot, datë 26.01.2021, ku konfirmohen të ardhurat nga paga, taksa e solidaritetit, shpërblime për Neritan Nallbati, për periudhën 01.02.2001 - 22.04.2002, në shumën 455.645 lekë, për periudhën 22.07.2003 - 22.11.2003, në shumën 262.009 lekë dhe dëmshpërblim page në datë 13.10.2006, sipas Vendimit të Gjykatës nr. 174, në shumën 632.363 lekë. (Nga të cilat: shpërblime në shumën 85.075 lekë + taksë solidariteti 57.514 lekë)
  - Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mestarë, lëshuar nga DV Policisë Vorë, ku konfirmohen të ardhurat nga paga për Neritan Nallbati, për periudhën 22.04.2002 - 21.07.2003, në shumën totale 669.907 lekë + shpërblime dhe taksë solidariteti për vitin 2002, në shumën 143.600 lekë. (konkretisht shpërblime në shumën 102.000 lekë dhe taksë solidariteti në shumën 41.600 lekë)
  - Vendim nr. 92 (80-2019-121) datë 22.01.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku është vendosur "Detyrimi i palës së paditur, DPPSH që ti njohë vjetërsinë në shërbim të punonjësit të policisë Neritan Nallbati, për periudhën nga dita e përjashtimit

- me Urdhrin nr. 992/1, datë 22.11.2003, të Zëvendës Ministrit të Rendit Publik, deri në ditën e pranimit në Policinë e Shtetit, në Urdhrin nr.2090/1 datë 09.10.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Bashkëlidhur praktika e Zyrës Përmbarimor, në lidhje me përlllogaritjen e detyrimit që rrjedh nga Vendimin. 92, datë 22.01.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kërkesë nr. 480, datë 08.07.2019 e DV Policisë Elbasan, drejtuar DRI Elbasan për pagimin e kontributeve për punonjësin Neritan Nallbati, për periudhën tatimore 22.11.2003 deri në 09.10.2013, në batim të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 92 (80-2019-121), datë 22.01.2019.
- Kthim përgjigj nga Ministria e Financave nr. 169 Prot, datë 04.07.2023. Konfirmohet se Neritan Nallbati, kreditor në Shoqërinë \*\*\*\*\*, me Kontratë nr. 14940, datë 13.01.1996, sipas kartelës 9 të përpunuar nga firma \*\*\*\*\* që ka pranë kësaj shoqërie, veprimet financiar të kryera janë: Depozituar në datë 13.01.1996, shuma 100.000 lekë, ku janë tërhequr interesat në datë 13.03.1996, në shumën 12.000 lekë dhe kanë mbetur për të marrë edhe 88.000 lekë, sipas koeficientit 11% = 9.680 lekë. Kurse për fondacionin \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, kanë mungesë dokumentacioni.
  - Nxjerrje llogarie nga Alpha Bank, ku konfirmohet kreditimi i pagës për Neritan Nallbati, për periudhën mars 2004 - dhjetor 2004, në shumën totale 360.000 lekë.
  - Vërtetim nga Firma e ndërtimit "\*\*\*\*\*" ShPK, datë 04.04.2012. Vërtetohet se Neritan Nallbati është punonjës pranë këtij subjekti, me page mujore 70.000 lekë. Bashkëlidhur Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, lëshuar nga "\*\*\*\*\*" ShPK, ku vërtetohet se të ardhurat për Neritan Nallbati, mbi bazën e të cilave janë derdhur kontributet, për periudhën 16.04.2010 - 15.10.2013 janë në shumën neto rreth 712.184 lekë. Nxjerrje llogarie nga BKT, ku konfirmohet kreditimi i pagës nga \*\*\* ShPK, për periudhën tetor 2010 - korrik 2013.
  - Vërtetim nr. 1060 prot, datë 03.07.2023, nga \*\*\*, ku vërtetohet se Neritan Nallbati, ka qenë punonjës pranë Fondacionit, prej datës 3.4.2018 deri në datën 26.10.2022.
  - Kërkesë për Regjistrimin e një interesi (kërkesë) për biznes dy punësimi, datë 03. 10.2017, nga Neritan Nallbati. Dakortësuar nga eprori I.K., datë 03.10.2017. Bashkëlidhur Kontrata e Punës me \*\*\* sha, datë 06.10.2017, për një afat 1 vjeçar, me page 125.000 lekë në muaj dhe koha normale e punës do të jetë jashtë orarit të punës aktuale që kryen në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.
  - Kërkesë për Regjistrimin e një interesi (kërkesë) për biznes dy punësimi, datë 27.08.2018, nga Neritan Nallbati. Dakortësuar nga eprori P. S., datë 27.08.2018. Bashkëlidhur Kontrata e Punës me \*\*\* datë 29.08.2018, për një afat 1 vjeçar, me page 120.000 lekë në muaj dhe koha normale e punës do të jetë jashtë orarit të punës aktuale, që kryen në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.
  - Kërkesë për Regjistrimin e një interesi (kërkesë) për biznes dy punësimi, datë 22.08.2019, nga Neritan Nallbati. Dakortësuar nga eprori. Bashkëlidhur Kontrata e Punës me \*\*\*\*\* datë 02.9.2019, për një afat 1 vjeçar, me page 120.000 lekë në muaj dhe koha normale e punës do të jetë jashtë orarit të punës aktuale që kryen në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.
  - Kërkesë (Leje dy punësimi), drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të DPPSH, në datë 24.09.2020, nga Neritan Nallbati. Bashkëlidhur Kontrata e Punës me \*\*\* datë 03.09.2020, për një afat 1 vjeçar, me page 120.000 lekë, në muaj dhe koha normale e punës do të jetë jashtë orarit të punës aktuale që kryen në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.
  - Kërkesë (Leje dy punësimi, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të DPPSH, në datë 10.10.2021, nga Neritan Nallbati. Bashkëlidhur Kontrata e Punës me \*\*\* datë 26.10.2021, për një afat 1 vjeçar me page 90.000 lekë në muaj dhe koha normale e punës do të jetë jashtë orarit të punës aktuale, që kryen në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.

- Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave (DIVA) për Neritan Nallbati, për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022.

### ***Konkluzion:***

- ✓ Të ardhurat e subjektit nga paga, shpërblimet, orë suplementare, taksë solidariteti dhe mësimdhënia për periudhën tetor 1991 - shkurt 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 25.220.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat e subjektit nga orë suplementare dhe shpërblime, për periudhën 01.03.1992 - 31.12.1993, në shumën 144.000 lekë. për periudhën 01.01.1994 - 31.12.199, në shumën rreth 256.773 lekë, si dhe nga Taksa e Solidaritetit për periudhën 01.04.1997 - 31.12.1998, në shumën 321.491 lekë.
- ✓ Të ardhura të pa llogaritura për mungesë informacioni financiar nga 364 orë shtesë + një page bazë mujore shpërblim + paga për 3 ditë festa zyrtare në vitin 1996 + 152 orë suplementare për muajin shtator - tetor 1998.

### **DETYRIMET FINANCIARE**

#### **Subjekti vlerësues Neritan Nallbati ka dhënë këto deklaramë të detyrimeve në vite:**

- Kartë krediti në Raiffeisen Bank, në euro.  
Detyrimi financiar i mbetur pa shlyer 1.000 euro.

#### **Hetimi administrativ**

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 08.05.2023, konfirmon kartë krediti me limit 1.000 euro. Gjendja e llogarisë në datë 09.03.2023, në shumën 78 euro.

### ***Konkluzion:***

- ✓ Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e ardhur nga Raiffeisen Bank.
- Kartë Krediti në Raiffeisen Bank, në lekë. Detyrimi i mbetur pas shlyer 150.000 lekë.

#### **Hetimi administrativ**

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 08.05.2023, konfirmon kartë krediti me limit 150.000 lekë.

### ***Konkluzion:***

- ✓ Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e ardhur nga Raiffeisen Bank.

## SHPENZIMET E DEKLARUESHME

Të vitit të fundit kalendarik për gira banesë, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur - Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.

- Shpenzime për ujë në UK Tiranë, bazuar në librezën me kontratë 136849, për periudhën e vitit të fundit në shumën 31.533 lekë.
- Shpenzime për drita në OSHEE, bazuar në librezën me nr. kontratë B-36750, për periudhën e vitit të fundit, në shumën 85.840 lekë
- Shpenzime për telefonat celular për familjen, për periudhën e vitit të fundit në Shumën 52.219 lekë.

### Hetimi administrativ

- ✚ **FSHU**, me shkresën nr. \*\*\*prot, datë 10.05.2023, konfirmon 1 abonent me emër Neritan Nallbati, me nr. kontratë furnizimi \*\*\* në instancën Tiranë. Adresa: \*\*\*. Shuma e paguar për vitin 2022 (dhjetor 2021-nëntor 2022) rreth 93.805 lekë.
- ✚ **Shoqëria Rajonal Ujësjellës - Kanalizime Tiranë**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 25.05.2023, konfirmon 1 kontratë në emër të Neritan Nallbati, me nr. \*\*\* për objektin me adresë; "\*\*\*\*", me status "aktiv", me detyrime të likuiduara deri në mars 2023. Shuma e paguar në vitin 2022, në shumën rreth 31.523 lekë. Bashkëlidhur; Certifikatë për vërtetim pronësie, apartament me sip. 112.30 m2 nr. pasurie \*\*\*\*, në emër të Neritan Nallbati. Kopje ID në emër të Neritan Nallbati.
- ✚ **Vodafone Albania**, me shkresën nr. \*\*\* Prot, datë 15.06.2023, konfirmon se në emër të Neritan Nallbati, figurojnë të regjistruar 4 numra telefoni (1 nga Drejtoria Vendore e Policisë + 3 si individ) nga të cilët njëri është numër inaktiv. Në emër të Nertina Nallbati figuron i regjistruar 1 numër telefoni. Shuma e paguar gjatë vitit 2022 në total 93.705 lekë.
- ✚ **14 Shoqëritë Rajonal të Ujësjellës - Kanalizime**, me shkresat nr. \*\*\*- \*\*\* prot, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- ✚ **One Albania sha**, me shkresën nr. \*\*\*prot, datë 31.05.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur, nuk rezulton të regjistruar në rrjetin fiks One Albania.
- ✚ **Albania Satelite Communications ShPK**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 15.05.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- ✚ **Abisinet sha**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 11.05.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- ✚ **Digicom ShPK**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 12.05.2023, konfirmon se Neritan Nexhat Nallbati, me nr. Kontratë \*\*\*\*\*, ka marrë shërbim internati dhe është faturuar me faturim mujor me vlerë 1.890 lekë, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022.

**Në procesverbalin e datës 05.07.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit subjekti ka sqaruar: “*Shpenzimet për numrin e tel. \*\*\*\*, në emër të Neritan Nallbati (nr. i institucionit), ku pagesa për vitin 2022 është 36.845 lekë, kreditohet nga institucioni në llogarinë e pagës dhe kjo vërtetohet nga nxjerrja e llogarisë*”.

#### **Subjekti paraqiti:**

- Informacion nga UKT, për abonentin Neritan Nallbati, me nr. kontratë \*\*\*. Konfirmohet pagesa e kryer për periudhën janar - dhjetor 2022, në shumën 31.523 lekë.
- Mandat arkëtimi në FSHU, ku konfirmohen pagesat e kryera për kontratën në emër të Neritan Nallbati, për janar - dhjetor 2022, në shumën rreth 90.168 lekë.
- Informacion për pagesën e numrave të telefonit, për periudhën janar –dhjetor 2022. Konfirmohet se pagesat janë kryer për 5, numra telefoni. Detyrimi total për vitin 2022, në shumën rreth 93.705 lekë.
- Kontratë pajtimi me Digicom, për ofrimin e shërbimit internet, datë 08.05.2021, me afat 12 muaj në shumën 1.890 lekë në muaj. Mandat arkëtimi datë 28.05.2022, nga Neritan Nallbati, për Digicom ShPK, për periudhën e faturimit maj 2022 - prill 2023, në shumën totale 22.680 lekë. (rezulton se pagesa për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, ka qenë 1.980 lekë/muaj = 22.680 lekë).

#### **Konkluzion:**

- ✓ Shpenzimet e deklaruara për ujë, drita, telefoni dhe internet gjatë periudhës së sipërcituar, me kontrata në emër të subjektit dhe/apo personave të lidhur me të rezulton në total rreth 238.000 lekë.

**Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara - Periudha 01.01.2020 — 31.12.2022.**

Shpenzime për dalje jashtë shtetit të subjektit Neritan Nallbati, gjatë tre viteve të fundit, rreth 820 euro.

- Shpenzime për dalje jashtë shtetit të bashkëshortes Nertina Nallbati, gjatë tre viteve të fundit, rreth 820 euro.
- Shpenzime për dalje jashtë shtetit të vajzës Laura Nallbati, gjatë tre viteve të fundit, rreth 2.110 euro.
- Shpenzime për dalje jashtë shtetit të vajzës Laura Nallbati, gjatë tre viteve të fundit. Rreth 2.050 euro.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**



- Lista e hyrjeve dhe daljeve nga pikat e kalimit kufitar për Neritan Nallbati dhe personat e lidhur për vitet 2020 - 2023. Konfirmohen 9 hyrje/dalje për subjektin, 3 hyrje/dalje për bashkëshorten dhe nga 9 hyrje /dalje për vajzat Laura dhe Levia Nallbati.
- Urdhër i DPPSH, nr. 160, datë 17.01.2023, për dërgimin me shërbim jashtë shtetit me nr. protokollin 494, datë 17.01.2023, nga 22.01.2023 - 24.01.2023. Shpenzimet do të mbulohen nga projekti IPA 2019 dhe WU4LWA.
- Urdhër i DPPSH, nr. 191, datë 17.01.2023, për dërgimin me shërbim jashtë shtetit me nr. protokollin 510/1, datë 27.01.2023, për periudhën 5.2.2023 - 9.2.2023. Shpenzimet do të mbulohen nga IOM.
- Urdhër i DPPSH, nr. 375, datë 02.03.2023, për dërgimin me shërbim jashtë shtetit me nr. protokollin 1531/1, datë 02.03.2023, për periudhën 08.03.2023 - 09.03.2023. Shpenzimet do të mbulohen nga pala organizatore.
- Urdhër i DPPSH, nr. 1180, datë 07.10.2022, për dërgimin me shërbim jashtë shtetit me nr. protokollin 7466/2, datë 07.10.2022, për periudhën 10.10.2022 - 12.10.2022. Shpenzimet ushqim dhe akomodim, bileta avioni etj., mbulohen nga DPPSH.
- Urdhër i DPPSH, nr. 741, datë 05.08.2021, për dërgimin me shërbim jashtë shtetit me nr. protokollin 5637, datë 05.08.2021, për periudhën 10.08.2021 - 12.08.2021. Shpenzimet ushqim dhe akomodim, bileta avioni etj., mbulohen nga DPPSH.
- Urdhër i DPPSH nr. 884, datë 23.09.2021, për dërgimin me shërbim jashtë shtetit me nr. protokollin 5724/1, datë 23.09.2021, për periudhën 10.10.2021 - 16.10.2021. Shpenzimet mbulohen nga pala organizatore.

**Në procesverbalin e datë 05.07.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit subjekti ka sqaruar: *“Të gjitha hyrjet dhe daljet e tij dhe personave të lidhur, vendin ku kanë udhëtuar dhe koston për secilin udhëtim dhe konkretisht.*

*Viti 2020; Neritan Nallbati*

*Dalje 26.10.2020 dhe hyrje 28.10.2022, në Stamboll Turqi, shpenzimi 400 Euro.*

*Dalje 30.11.2021 dhe hyrje 03.12.2021, në Frankfurt Gjermani për ceremoninë e prezantimit të vajzës Laura Nallbati, qëndrimi dhe ushqimi në shtëpinë e vajzës, shpenzimi 120 Euro.*

*Dalje 28.10.2022 dhe hyrje 30.10.2022, në Bari Itali, për një ditëlindja të vajzës së tezes së bashkëshortes e cila jeton atje F.Sh, pa fjetje vetëm vajtje ardhje me traget, shpenzimi 300 Euro.*

*Shpenzimet për udhëtimet private kanë qenë gjithësie 820 euro.*

*Dalje 10.08.2021 dhe hyrje 13.08.2021, në Stamboll me shërbim nga institucioni,*

*Dalje me 11.10.2021 dhe hyrje me 15.10.2021, në Pragë Ceki me shërbim sipas Urdhrit nr. 884, datë 23.09.2021.*

*Dalje me 10.10.2022 dhe hyrje me 12.10.2022, në Vjenë me shërbim sipas Urdhrit Nr. 1180, datë 7.10.2022.*

*Dalje me 6.12.2022 dhe hyrje me 9.12.2022, në Pragë Ceki, me shërbim sipas Urdhrit nr. 1285, datë 2.11.2022.*

*Dalje me 22.1.2023 dhe hyrje 24.1.2023, në Romë Itali me shërbim sipas Urdhrit nr.*

160, datë 17.1.2023.

Dalje me 5.2.2023 dhe hyrje me 9.2.2023, me shërbim në Budva Mali i Zi, sipas Urdhrit nr. 191, datë 27.1.2023.

*Neritan Nallbati*

Dalje 26.10.2020 dhe hyrje 28.10.2022, në Stamboll Turqi, shpenzimi 400 Euro.

Dalje 30.11.2021 dhe hyrje 3.12.2021 në Frankfurt Gjermani për ceremoninë e prezantimit të vajzës Laura Nallbati, qëndrimi dhe ushqimi në shtëpinë e vajzës, shpenzimi 120 Euro.

Dalje 28.10.2022 dhe hyrje 30.10.2022, në Bari Itali, për një ditëlindja të vajzës së tezes e cila jeton atje F.Sh., pa fjetje vetëm vajtje ardhje me traget, shpenzimi 300 Euro.

Shpenzimet për udhëtimet private kanë qenë gjithsej 820 euro.

*Laura Nallbati*

Hyrje me 22.12.2019 dhe dalje me 11.1.2020, udhëtim nga Frankfurti në Tiranë për pushimet e fund vitit.

Hyrje me 9.8.2020 dhe dalje me 16.8.2020, udhëtim nga Frankfurti për në Tiranë, vizitë tek prindërit.

Hyrje me 23.12.2020 dhe dalje me 03.1.2021, udhëtim nga Frankfurti në Tiranë për pushimet e fund vitit, në Tiranë.

Hyrje me 16.5.2021 dhe dalje me 30.5.2021, udhëtim nga Frankfurti për në Tiranë, vizitë tek prindërit në Tiranë.

- ✚ **Fibank**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 08.05.2023, konfirmon: Depozite në emër të Neritan Nallbati për periudhën 22.05.2008 - 09.11.2009. Depozituar shuma 1.500.000 lekë, në datë 22.05.2008 dhe tërhequr në datë 23.06.2008, në shumën 1.505.289 lekë. Llogari rrjedhëse për periudhën 22.05.2008 - 18.09.2017, në të cilën janë kryer shlyerjet e kredisë. Kredi e marrë në datë 05.04.2012, në shumën 250.000 lekë. Mbyllur në datë 28.08.2017. Depozitë në emër të bashkëshortes Neritan Nallbati, hapur në datë 22.05.2008, në shumën 1.400.000 lekë dhe mbyllur në datë 23.06.2008, në shumën 1.404.936 lekë. Llogari rrjedhëse për periudhën 22.05.2008 - 03.02.2017. Llogari kursimi, hapur në datë 30.12.2014, në shumën 12.000 lekë dhe mbyllur në datë 26.01.2015, ku është tërhequr shuma 12.016 lekë. Llogari kursimi në emër të vajzës Laura Nallbati, hapur në datë 14.08.2013, në shumën 9000 euro dhe me balancë në datë 09.03.2023, shumën 106 euro. Transferuar shuma 8.257 euro në Llogarinë e B. Sh., me përshkrimin "Kalim për ekzekutim transferte". Nuk ka lëvizje të tjera në atë llogari, prej datës 27.8.2013. Llogari kartë krediti hapur në datë 14.08.2013 dhe mbyllur në datë 21.03.2019.

**Në procesverbalin e datë 05.07.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit, subjekti ka sqaruar: *“Burimi i krijimit të dy depozitave në datë 22.05.2008 kanë qenë kursime nga të ardhurat e tij ndër vite. Ka sqaruar se sipas llogarive të tij, të ardhurat deri në vitin 2008 kanë qenë rreth 6.554.970,5 lekë, duke zbritur këtu dhe shlyerjen e shumës për blerjen e shtëpisë në Rrugën \*\*\*, prej 1.800.000, ndër vite deri në vitin 2010, gjithashtu nëse marrim parasysh qëndrimin e tij tek vjehri, pa shpenzime banesë dhe ushqimi, në gjykimin e tij ka pasur të ardhura për justifikimin e kësaj depozitë.*

*Përsa i përket destinacionit të tyre pas tërheqjes, ka deklaruar se duke qenë se kishte dalë pa pune, i duheshin ti kishte gjendje për ndonjë problematikë familjare. Në datën 5.4.2012 ka marrë një kredi konsumatorë për të bërë disa rregullime në shtëpinë e tij, si shtrim të dhomës me parket dhe rregullimin e dritareve të shtëpisë. Kredia është shlyer sipas normave të vendosura në kontratë ndër vite, deri me 28.08.1017.*

*Burimi i shumës 9.000 euro, në llogarinë e kursimit të vajzës Laura Nallbati, në datën 14.08.2013, ka qenë nga të ardhurat ndër vite dhe tërheqje e depozitave në Fibank në vitin 2008 dhe janë përdorur për çeljen e llogarisë se shkollës dhe transferimin e tyre në Gjermani, për shpenzime jetese dhe shkollimi. Qëllimi i transferimit të kësaj shumë në llogarinë e B. Sh. është veprim bankar për ekzekutim transferte, pasi B. Sh. është familjare e tyre, përkatësisht vajza e tezes e bashkëshortes dhe në këtë kohë ishte punonjëse e bankës dhe e ka bërë këtë veprim për ekzekutim të shpejtë transferte. Për këtë disponon edhe dokumentin e ekzekutimit të transfertes që ndodhet bashkëlidhur.*

**Subjekti paraqiti:**

- Nxjerrje llogarie nga Fibank, në emër të Neritan Nallbati, ku konfirmohet disbursim kredie në shumën 250.000 lekë, në datë 05.04.2012 dhe pagesat e kësteve të saj deri në datë 28.08.2017.
- Vërtetim nr. \*\*\* Prot, datë 03.07.2023 nga Fibank, ku konfirmohet së B. Sh., ka qenë punonjëse e bankës, në pozicionin, Drejtor i Agjencisë "\*\*\*\*\*", nga periudha 26.07.2010 deri në 07.10.2013.
- Faturë pagese datë 27.08.2013, nga Laura Nallbati, e shumës 8.257 euro për llogari të B. Sh. dhe shumës 740 euro në llogarinë e Laura Nallbati.

**Në procesverbalin e datë 31.07.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit, subjekti ka sqarua: *“Transferimi i shumës 8.257 euro, në llogarinë e B. Sh është bërë me qëllim ekzekutimi të veprimit të transferimit nga Znj. B. Sh., meqenëse B. Sh. është lidhje familjare e tyre dhe në atë kohë ka qenë punonjëse e Fibank. Këtë fakt e ka vërtetuar me një vërtetim që e ka vënë në dispozicion me herët. Megjithatë për të bërë të mundur një shpjegim shterues, i ka kërkuar shkresarësh kësaj banke me datën 27.07.2023, që ti vërë në dispozicion të gjithë praktikën e veprimeve bankare për këtë rast.*

*Ndërsa përsa i përket shumës së ngurtësuar, që në datë 16.08.2013, ka sqaruar së në këtë datë është bërë aplikimi online për çeljen e llogarisë në Deutche Bank. Pra vlera në formularin e datës 16.08.2013, nuk është gjë tjetër vetëm një kërkesë për të bërë të mundur veprimet e mëtejshme të ngurtësimit të shumës 8.200 euro. Shuma është transferuar në datë 27.08.2013.*

#### **Subjekti ka paraqitur:**

- Kërkesë, drejtuar Fibank, në datë 27.07.2023, për vënie në dispozicion të një dokumenti që tregon procedurën e ndjekur për kalim ekzekutim transfertë në datë 27.08.2013, me nr. ref.\*\*\* Bashkëlidhur fatura e dërgesës së kërkesës.
- Konfirmim për debitim llogarie, nga Fibank, datë 31.07.2023, ku konfirmohet transferimi i shumës 8.200 euro nga B.Sh., në llogarinë e Laura Nallbati në Gjermani, në datë 27.08.2013, me përshkrimin "Kalim personal për shpenzime studimi".

#### **Konkluzione:**

- ✓ Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me veprimet e konfirmuara nga Fibank.
- ✚ **Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 15.05.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të Levia Nallbati, me balancë në datë 09.03.2023, shumën 9.680 lekë. Llogari në të cilën ka kaluar bursa si nxënës me rezultate për periudhën 2014 - 2019.
- ✚ **OTP Bank**, me shkresën nr.\*\*\* prot, datë 05.05.2023, konfirmon llogari në emër të Neritan Nallbati në Alpha Bank, për periudhën 02.03.2009 deri në 24.10.2017. (Nuk ka lëvizje në llogari për këtë periudhë kohore).
- ✚ **Unioni Financiar Tiranë**, me shkresën nr. \*\*\*, datë 08.05.2023, konfirmon së për periudhën 26.04.2018 - 09.03.2023, rezultojnë 8 transaksione dalëse në emër të Neritan Nallbati, gjithsej në shumën 1.450 euro dhe 2 transaksione dalëse në emër të Levia Nallbati në shumën totale të dërguar 200 euro.

Në procesverbalin e datë 05.07.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit subjekti ka sqarua: “...janë kryer gjithsej 8 transaksione me Wester Union, si me poshtë.

- Datë 19.12.2018, drejt Laura Nallbati shuma 300 euro.
- Datë 20.03.2019, drejt Laura Nallbati shuma 200 euro
- Datë 10.02.2020, drejt Laura Nallbati shuma 100 euro
- Datë 10.02.2020, drejt Levia Nallbati shuma 100 euro
- Datë 10.03.2020, drejt Laura Nallbati, shuma 150 euro
- Datë 19.03.2020, drejt Levia Nallbati, shuma 300 euro
- Datë 07.03.2021, drejt Laura Nallbati, shuma 150 euro
- Datë 07.03.2021, drejt Levia Nallbati, shuma 150 euro.

Këto transaksione janë kryer për vajzat e tij, si një stimul për mbarëvajtjen shumë të mirë të tyre në mësim, si studente, shuma është 1.450 euro gjithsej. Ka dorëzuar

- Vërtetim nga Unioni Financiar Tiranë nr. 271 prot, datë 04.07.2023, ku konfirmohen gjithsej 8 transaksione Western Union nga Neritan Nallbati, për periudhën 03.07.2018 - 2.07.2023. Bashkëlidhur tabela përkatëse.

#### **Konkluzion:**

- ✓ Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me veprimet e konfirmuara nga Unioni Financiar Tiranë.

✚ **DPSHTRR**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 08.05.2023, nuk konfirmon asnjë mjet të regjistruar në pronësi të subjektit dhe personave të lidhur me të.

✚ **QKB**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 04.05.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur, nuk figurojnë të jenë pajisur me NUIS (NIPT), si persona fizikë apo të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrimit tregtar.

✚ **DPI**, me shkresën nr.\*\*\* prot, datë 12.05.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur, nuk figurojnë të regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.

✚ **Drejtoria e Përgjithshme Detare**, me shkresën nr. \*\*\*prot, datë 10.05.2023, nuk konfirmon mjet lundrues në pronësi të subjektit dhe personave të lidhur me të.

✚ **ASHK ZV Korçë**, me shkresën nr.\*\*\* prot, datë 23.06.2023, konfirmon se Neritan Nexhat Nallbati, figuron bashkëpronar me N.N., D.N., A.N. dhe V.N, në pasurinë nr.\*\*\*, vol.\*\*\*, fq.\*\*\* ZK \*\* Korçë, e llojit apartament me sip. 68.2 m2, e përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* Rep, nr. \*\*\* Kol, datë 04.12.1995. Bashkëlidhur:

- Kartela e pasurisë, Mandat pagese nga N. N, nr.\*\*\*, datë 15.12.1993, e shumës 14.244 lekë.
- Autorizim nga Këshilli Popullor i Lagës nr.\*\*\* , Korçë, datë 02.06.1992, për N. N., i cili përfiton strehim 2 dhoma e 1 kuzhine.
- Kontratë Privatizimi banese datë 26.11.1993. Vlera e banesës 14.244 lekë.
- Kontratë Shitblerja nr.\*\*\* Rep, nr.\*\*\* kol, datë 04.12.1995, me EKB Korçë.

**Në procesverbalin e datës 05.07.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit subjekti ka sqarua: *“Me Prokurën e Posaçme me nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol, ka bërë heqjen dorë nga kjo pasuri dhe a ka kaluar pjesën e tij babait N.N.”.*

#### **Subjekti paraqiti:**

- Prokurë e Posaçme nr. \*\*\* Rep, nr. \*\*\* Kol, datë 03.03.2011, ku Neritan Nallbati ka deklaruar se është bashkëpronar në një apartament të ndodhur në Korçë, Rr. “\*\*\*\*” Lagjja nr. \*\*\*, pasuria \*\*\*, ZK\*\*\*, vol.\*\*\*, fq.\*\*\*, duke pasur 1/5 pjesë të pandarë të saj. Meqenëse do të kryejnë veprime tjetërsimi për këtë prone, ka emëruar bashkëpronarin tjetër N.N., të cilit i jep të drejtë të paraqitet në ZVRPP, për të tërhequr dokumentet e pronësisë, certifikatën e pasurisë, hartën treguese dhe kartelën e pasurisë. Përfaqësuesi ka të drejtë të paraqitet në çdo zyrë Noteriale dhe të nënshkruajë në emrin e tij, kontratën e shitblerjes, ku Neritan Nallbati do jetë në cilësinë e shitësit. Përsa i përket Kontratës së Shitblerjes, ta tjetërsojë atë tek vetja e tij, në bazë të nenit 67 të Kodit Civil, ose tek do person tjetër që do e shohë të arsyeshme, pasi të përfundojë kontrata ta çojë atë për transkriptim në ZVRP dhe të paguajë tatimin që na takon si shitës.  
Bashkëlidhur Certifikata për vërtetim pasurie në emër të N. N., D.N., Neritan Nallbati, A. N., V.N., apartament me sip. 68.2 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\* në Korçë.

**Në procesverbalin e datë 31.07.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit, subjekti ka sqarua: *“...se ka paraqitur Prokurë të Posaçme nr. \*\*\* Rep, nr.\*\*\* Kol, datë 03.03.2011, ku i ka dhënë tagër babait të tij për kryerjen e veprimeve në emrin dhe për llogarinë e tij si bashkëpronar, ndër të tjera dhe të drejtën për tjetërsim. Akt i përfundimit të kontrollit të plotë apo regjistrim të saj në emrin e tij. Ka sqaruar së mbas përpilimit të kësaj Prokurë të Posaçme, babai i tij e ka quajtur si të mirëqenë pronësinë ndaj kësaj banesë dhe vetëm tani ai ka bërë veprime në lidhje me këtë fakt dhe për këtë paraqet aplikimin e bërë nga babai i tij N.N, në ZVRPP Korçë, datë 10.07.2023, si dhe mandat pagesën dhe dëftesën e pranimit të objekteve postarë, të cilat administrohen në dosje.*

#### **Konkluzion:**

- ✓ Subjekti i vlerësimit në lidhje me pronën me sip 68.2 m<sup>2</sup> dhënë sqarime në lidhje me veprimet e konfirmuara nga ASHK ZV Korçë.

**Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiarë të deklaruar dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruar, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesave, u bë analiza e të dhënave të deklaruar nga subjekti më informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, proces nga i cili, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se:**

- Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, pasuria totale deri në datë 09.03.2023 është deklaruar bruto/neto **4.705.564 lekë + 34.615 Euro, e konvertuar rreth 8.676.000 lekë**
- Të ardhurat e subjektit, për periudhën tetor 1991 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth **25.220.000 lekë.**



- Të ardhurat e subjektit nga orë suplementarë shpërblime, për periudhën 01.03.1992 - 31.12.1993, në shumën 144.000 lekë, për periudhën 01.01.1994 - 31.12.1997, në shumën rreth 256.773 lekë, si dhe nga Taksa e Solidaritetit për periudhën 01.04.1997 - 31.12.1998 në shumën 321.491 lekë.
- Të ardhura të pa llogaritura për mungesë informacioni financiar nga 364 orë shtesë + një pagë bazë mujorë shpërblim + paga për 3 ditë festa zyrtarë në vitin 1996 + 152 orë suplementare për muajin shtator - tetor 1998.
- Të ardhurat e bashkëshortes, për periudhën shtator 1991 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 11.401.000 lekë.
- Të ardhurat e vajzës Laura Nallbati, për periudhën 2007 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 5.732.000 lekë.
- Të ardhurat e vajzës Levia Nallbati, për periudhën 2014 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 754.000 lekë.

Gjithashtu, ka deklaruar si burim;

- Dhuratë nga prindërit në vitin 1998, shuma 250.000 lekë.
- Të ardhura nga firmat rentjeren ë vitet 1995 - 1996, rreth 800.000 lekë.
- Trajtimin ushqimor në Qendrën e Trajtimit Durrës, në vitin 2000.
- Ndihmë nga prindërit e bashkëshortes, në vitet 1994 - 2003, ku ai dhe familja e tij kanë qëndruar gjatë kësaj periudhën.
- Për periudhën 2000 - 09.03.2023, referuar treguesve statistikorë të INSTAT, janë shpenzuar minimalisht për konsum familjar, rreth 12.700.000 lekë.
- Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, janë shpenzuar për, ujë, drita, telefon dhe internet etj., në total rreth 238.000 lekë.
- Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, janë shpenzuar për udhëtime privatë personale dhe të personave të lidhur më të, rreth 5.800 Euro, konvertuar rreth 665.000 lekë.
- Për periudhën deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, janë shpenzuar për arsimimin e personave të lidhur, në total rreth 121.000 euro, konvertuar rreth 13.886.000 lekë.
- Për periudhën 1999 - 09.03.2023. janë shpenzuar për mobilim apartamenti, në total rreth 475.000 lekë.

✓ **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancën dëgjimore dhe në përfundim arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit:

- **Ka bërë deklaram të saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- **Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- **Nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- **Nuk është kryer deklarim i rremë;**

- **Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit**

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:

1. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
2. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
3. Verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, germa (ë), e ligjit 12/2018, i ndryshuar.

✚ Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të vlerësimit z. **Neritan Nallbati** me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë së deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

✚ **Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:**

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
- c. Korrespondencën me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë.

✚ Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore si organ ndihmës, në përputhje me nenin 42 të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, për vlerësimin e kontrollit të figurës ka dorëzuar nëpërmjet shkresës Nr.\*\*\* datë 20.07.2023 raportin e kontrollit të figurës<sup>2</sup> ku ka konstatuar se:

---

<sup>2</sup> Raporti mbi kontrollin e figurës nr.\*\*\*\*\* datë 20.07.2023

**Subjekti i vlerësimit z. Neritan Nexhat Nallbati, me detyrë, Drejtor i Departamentit të Policisë Kriminale, në Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.**

**Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:**

- Nuk ka pasur emër apo mbiemër tjetër më parë.
- Nuk është njohur nga të tjerët me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër nga ai që keni pasur apo keni regjistruar në gjendjen civile.
- Nuk ka pasur apo ka shtetësi tjetër.
- Nuk ka qenë dënues ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
- Nuk ka qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një veprë penale.
- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një veprë penale.
- Nuk është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale.
- Nuk është lëshuar ndonjëherë urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Nuk ka asnjë djeni se një nga anëtarët e familjes është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka patur asnjë kontakt të papërshtatshëm në formën e një takimi, komunikimi elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës.
- Nuk ka patur asnjë kontakt të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka patur djeni që një nga anëtarët e familjes ka patur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar, shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasur me asnjë person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka patur djeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE-së/Nato-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet tjetër.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit.

Po ashtu, subjekti ka nënshkruar edhe dy vetdeklarimet për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

- **Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, Trupa e vlerësimit konstatoi se:**
  1. **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile** me shkresën nr.\*\*\*, prot, datë 05.06.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Neritan Nexhat Nallbati, bën me dije se:
    - a. Nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve të subjektit të vlerësimit Z. Neritan Nexhat Nallbati,
    - b. Nuk ka ndryshuar shtetësi (lenie ose marrje shtetësie).
  2. **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve,** me shkresën nr. \*\*\*, prot, datë 19.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Neritan Nexhat Nallbati, bën me dije se:
    - a. Nuk rezulton i dënuar.
  3. **Institucioni ligjzbatues,** me shkresën nr.\*\*\*\* prot., datë 25.05.2023, ka bërë me dije se, ka disponuar informacione për subjektin e vlerësimit, të cilat pas verifikimeve të kryera kanë rezultuar se nuk janë të dhëna të vërtetuara, në kuadër të dyshimit të arsyeshëm.
  4. **Institucionet Ligjzbatuese,** me shkresën nr. \*\*\*, prot. datë 30.05.2023, informojnë se subjekti i vlerësimit Z. Neritan Nexhat Nallbati, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, **nuk kanë :**
    - a. Të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
    - b. Të dhëna për kontakte të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar, *(sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”)* ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj.;
    - c. Të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm *(persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar);*
    - d. Të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale;
    - e. Të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhri ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale,
    - f. Të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj,
    - g. Të dhëna në lidhje nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATOS-s;
    - h. Të dhëna nëse nga subjekti është azil politik në ndonjë shtet;
    - i. Nuk ka procedim disiplinor apo masa disiplinore.
  5. **Institucionet Ligjzbatuese,** me shkresën, nr. \*\*\*, prot. datë 31.05.2023, informojnë se subjekti i vlerësimit Z. Neritan Nexhat Nallbati, bën me dijeni:

- a. Nuk disponon të dhëna
6. **Institucionet Ligjzbatuese**, me shkresën, nr. \*\*\*, prot. datë 31.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Neritan Nexhat Nallbati, bën me dije se:
  - a. Nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitet të paligjshëm;
  - b. Nuk ka procedime penale të referuara;
  - c. Për subjektin e vlerësimit nuk administrohen ankesa, të dhëna ose informacione;
7. **Institucionet Ligjzbatuese**, me shkresën, nr. \*\*\*, prot. datë 31.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Neritan Nexhat Nallbati, bën me dije se **nuk** :
  - a. Është nxjerrë urdhër ndalimi;
  - b. Është kërkuar masë e sigurimit personal dhe nëse po, vlerësimi i tyre nga gjykata;
  - c. Është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
  - d. Ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale;
  - e. Ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.
8. **Institucionet Ligjzbatuese**, me shkresën nr.\*\*\*. Prot, datë 25.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Neritan Nexhat Nallbati dhe personat e lidhur me të:
  - a. Rezultuan raportime, për të cilat pas verifikimeve të kryera janë të dhëna rutinore të raportuara nga bankat në kuadër të informimit.
9. **Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar**, me shkresën nr.\*\*\*. Prot, datë 25.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Neritan Nexhat Nallbati, bën me dije se:
  - a. Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), nivelin “Tepër Sekret” lëshuar më datë 08.09.2022, e vlefshme deri më datë 07.09.2027. Nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP.
  - b. AKSIK nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.
10. **Avokati i Popullit**, me shkresën nr.\*\*\*, Prot, datë 30.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Neritan Nexhat Nallbati, bën me dije se:
  - a. Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
  - b. Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.
11. **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**, me shkresën, nr.\*\*\*. Prot, datë 08.06.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Neritan Nexhat Nallbati, bën me dije se:
  - a. Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri 2 Korrik 1991.

### **Denoncime nga publiku**

Për subjektin e vlerësimit z. Neritan Nallbati ka denoncime nga një qytetarë i cili pretendon për përfshije në aktivitet kriminal të subjektit të vlerësimit.

- ✘ Trupa e vlerësimit pas analizimit të dokumentacionit të administruar dhe fakteve të reja të konstatuara gjatë hetimit administrative denoncimeve të administruara ka kryer verifikime shtesë. Nga verifikimet e kryera nga institucionet ligj zbatuese pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë

### **Testi për përdorim lëndësh narkotike:**

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, për përdorim lëndësh narkotike, me nr. \*\*\*, datë 11.01.2024, “Akt Ekzaminimi Toksikologjiko-Ligjor” kolaudohet se subjekti vlerësimit **z. Neritan Nallbati:**

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, kolaudohet se subjekti vlerësimit **z. Neritan Nallbati:**

- **Nuk janë zbuluar prania e substancave narkotike.**

### **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit Neritan Nallbati, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, analizimit dhe verifikimit të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, vlerësimit të testit për përdorim lëndësh narkotike, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, arriti në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit z. Neritan Nallbati:

- ***Ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;***
- ***Nuk ka informacion në deklaramin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.***

## C . VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
- raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standartet profesionale në Policinë e Shtetit, dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 05.07.2023, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit 12/2018, i ndryshuar

Subjekti i vlerësimit **Z. Neritan Nallbati** në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e “Drejtor i Departamentit të Policisë Kriminale në Policinë e Shtetit”. Në momentin e hedhjes së shortit dhe përzgjedhjes së trupës së vlerësimit datë 05.04.2023 subjekti i vlerësimit mbante po funksionin e Drejtor i Departamentit të Policisë Kriminale në Policinë e Shtetit”.

Periudha e vlerësimit në zbatim të nenit 44 pika 2 të ligjit 12/2018 i ndryshuar është periudha 5-vjeçare (2018-2022). Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale do të shkrihet brenda këtij harku kohor.

### C/1 RAPORTI I VLERËSIMIT PROFESIONAL POLICIA E SHTESTIT.

Struktura e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si organ ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr.12/2018 i ndryshuar ka dorëzuar nëpërmjet shkresës nr. \*\*\*, datë 30.06.2023, raportin e vlerësimit profesional është shprehur me Konkluzion përfundimtar si më poshtë vijon:

“Punonjësi i Policisë **z. Neritan Nallbati** është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme duke rezultuar i kualifikuar për të ushtruar funksionin që mban”.

## **C/2 HETIMI I TRUPËS SË VLERËSIMIT PRANË AGJENCISË SE MBIKËQYRJES POLICORE:**

✚ Trupa e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me ligjin e vlerësimit si dhe ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, ka zhvilluar një hetim administrativ të plotë dhe të bazuar në fakte dhe prova duke u bazuar në:

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit;
- Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 1 të ligjit nr.12/2018 i ndryshuar.
- Të dhënat e siguruar nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi performancën e subjektit.

✚ Punonjësi i Policisë, Drejtues i Lartë Neritan Nallbati është i emëruar në detyrë, Drejtor i Departamentit të Policisë Kriminale në Policinë e Shtetit, me Urdhrin nr.\*\*\* datë 28.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

✚ Në zbatim të ligjit 12/2018 i ndryshuar, funksioni që mban z. Neritan Nallbati e bën atë subjekt të ligjit sipas nenit 6.

### **Vlerësimi i nivelit të arsimit.**

<b>Niveli i arsimit</b>	<b>Institucioni ku janë ndjekur studimet</b>	<b>Fillimi</b>	<b>Përfundimi</b>	<b>Titulli/Diploma</b>
Bachelor	Universiteti “Aleksandër Xhuvani”	1989	1991	Diplomë (Mësues për ciklin e ulët)
Kurs 5-mujor të Policisë	Akademia e Policisë	01.10.1991	28.02.1992	
Master Profesional	Universiteti “Aleksandër Xhuvani”	2015	2017	Diplomë (Ekonomia dhe drejta në sektorin publik)

### ***Konkluzion:***

- ✓ Trupa e vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore administroj nga dosja e subjektit të vlerësimit diplomën me nr. regjistri \*\*\*;
- ✓ Në kuptim të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar punonjësi/subjekti përmbush kriterin e



nivelit arsimor për funksionin që mban pranë Policisë së Shtetit, në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.

### **Ecuria në karrierë**

Nga verifikimi i të dhënave të deklaramit të subjektit të vlerësimit, raportit të vlerësimit profesional nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, subjekti i vlerësimit Neritan Nallbati ka një karriera në Policinë e Shtetit prej 21 vitesh e 8 muaj. Nga verifikimi në dosje personale rezulton se gjatë periudhës 5-vjeçare objekt deklarimi, subjekti mban:

<b>Institucionit ku punon/ka punuar</b>	<b>Fillimi</b>	<b>Përfundimi</b>	<b>Vendi</b>	<b>Pozicioni</b>
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	01.08.2022	Vazhdim	Tiranë	Drejtor, Departamenti i Policisë Kriminale
Drejtoria Vendore e Policisë Durrës	19.10.2021	31.07.2021	Durrës	Drejtor, Drejtoria Vendore e Policisë Durrës
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	06.07.2021	18.10.2021	Tiranë	Drejtor, Departamenti për Sigurinë Publike
Drejtoria Vendore e Policisë Berat	12.06.2020	05.07.2021	Berat	Drejtor, Drejtoria Vendore e Policisë Berat
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	22.07.2019	11.06.2020	Tiranë	Drejtor, Drejtoria e Standardeve Profesionale
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	31.05.2017	21.07.2019	Tiranë	Këshilltar: Zyra Ndihmëse e Drejtorit të Policisë së Shtetit

- **Gradën “Drejtues i Lartë”**

<b>Emërtimi i gradës</b>	<b>Arsyeja e ndryshimit</b>	<b>Nr. Urdhrit</b>	<b>Data</b>	
			<b>Nga</b>	<b>Deri</b>
Drejtues i Lartë	Emërimi në detyrë Drejtor Departamenti	Nr. ***, datë 28.07.2022	01.08.2022	
Drejtues i Parë	Liruar nga detyra e Drejtorit të Departamentit	Nr. ***, datë 21.10.2021	19.10.2021	31.07.2022
Drejtues i Lartë	Emërimi në detyrë Drejtor Departamenti	Nr. ***, datë 05.07.2021	06.07.2021	18.10.2021
Drejtues i Parë	Ri certifikuar për gradë policore	Nr. ***, datë 02.06.2014	01.06.2014	05.07.2021

### **Konkluzion:**

- ✓ Subjekti i vlerësimit, Neritan Nallbati është transferuar dhe emëruar në pozicionin aktual me Urdhrin nr.\*\*\* datë 28.07.2022, të Ministrit të Brendshëm në përputhje me në nenin 53 pika 3, të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, nenet 162,pika 4 dhe 170 pika 13, të Rregullores së Policisë së Shtetit, e ndryshuar si dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
- ✓ Me urdhër nr. \*\*\*, datë 27.04.2017, “Për dhënien e gradës policore dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie”, bazuar në ligjin nr.108/2014,i ndryshuar të Policisë së Shtetit dhe Rregullores së Policisë së Shtetit, të ndryshuar subjektit të vlerësimit i është dhënë grada policore “Drejtues i Parë”.
- ✓ Sipas deklarimeve të vetë subjektit dhe vërtetimeve që ka sjellë, ai ka një karrierë në Policinë e Shteti rreth 21 vite e 8 muaj.

### **Trajnime / Kualifikime**

- ✚ Trupa e vlerësimit pas administrimit të dosjes së personelit, raportit të vlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, konstatoj se gjatë periudhës 5 vjeçare të vlerësimit në zbatim të ligjit 12/2018 . Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit, rezulton se ka kryer trajnimet/specializimet si vijojnë:

<b>Nr.</b>	<b>Viti</b>	<b>Emërimi i trajnimit</b>	<b>Lloji i dokumentit</b>
1.	1996	Kurs për drogat	Certifikatë
2.	1999	Strategjia e Policisë ekzekutive	Certifikatë
3.	2000	Promovimi i të drejtave të fëmijëve në Gjykatë, Prokurori dhe burgje	Certifikatë
4.	2000	Marrë pjesë në seminarin “Leokrates “2000” Policia dhe Komuniteti “ zhvilluar në Athinë Greqi, ku ka mbajtur dhe referatin e palës shqiptare.	Certifikatë
5.	2000	Pjesëmarrje në nivel eksperti “Takimi i Policive të Vendeve të Adriatikut:, Rimë (Itali)	Certifikatë
6.	2001	Trajnim ICITAP “Dhuna në familje”	Certifikatë
7.	2003	Trajnim “ Menaxhimi i nivelit të lartë nga ICITAP”	Certifikatë
8.	2011	Trajnim “ Menaxhimi i Lartë për drejtuesit e Ministrisë së Rendit Publik”	Certifikatë
9.	2014	Trajnim OSCE “Fushata kundër dhunës në familje”	Certifikatë
10.	2017	Trajnim “Perspektiva Gjimore në Policim”	Certifikatë
11.	2017	Trajnim “Gjuha angleze”	Certifikatë
12.		Trajnim “Policia dhe të drejtat e njeriut, Kopenhagen”	Certifikatë
13.		Honorary Truman Aviator	Certifikatë

Gjithashtu, gjatë karrierës se subjekti ka marrë 2 certifikata për performancë të lartë në realizimin e detyrave e konkretisht:

Nr.	Viti	Emërimi i trajnimit
1.	2017	Certifikatë për shërbime të dalluara
2.	2019	Certifikatë për shërbime të dalluara

### **Pjesëmarrja në konferenca shkencore workshop-e seminare botime brenda dhe jashtë vendit**

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar se për periudhën objekt vlerësimi, është angazhuar si vijon:

- Me Urdhër Nr. 321, date 15.09.2021, të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinise jam emëruar anëtar i Bordit të Administrimit të Akademisë së Sigurisë.
- Me Urdhër Nr. 837, date 10.09.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, kam qenë Kryetar i grupit të punës "Për vlerësimin dhe kategorizimin e funksioneve për rolin zbatues, në strukturat organike të Policisë së Shtetit.
- Me Urdhër Nr. 588/1, date 08.07.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, kam qenë anëtar i grupit të punës për projektligjin "Për Policinë Bashkiake".
- Me Urdhër Nr. 151, date 09.02.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, kam qenë anëtar i grupit të punës "Për riorganizimin dhe Funksionimin e Policisë Kriminale në Policinë e Shtetit".
- Me Urdhër Nr. 1072, date 13.09.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, kam qenë anëtar i grupit të punës "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin 108, 2014, për Policinë e Shtetit".
- Me Urdhër Nr. 1063, date 08.09.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, kam qenë anëtar i grupit të punës "Për hartimin e programit, për zbatimin e prioriteteve të përcaktuara nga Kryeministri i Shqipërisë".
- Pjesëmarrës në workshop në Budva të Malit të Zi, me vendet e Ballkanit Perëndimor, për luftën ndaj emigrantëve të paligjshëm.
- Në detyrat menaxheriale dhe operacionale, kam përgatitur e zhvilluar analiza pune tremujore, gjashtë mujore, vjetore të strukturave që kam drejtuar, po ashtu dhe për ngjarje të rënda kriminale, apo për probleme të rendit e sigurisë, etj.

### **Vlerësimet e Punës.**

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale , pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe verifikimeve në sistemin RMIS, subjekti për periudhën 2018-2023 objekt verifikimi ka rezultuar lidhur me "Vlerësimin e rezultateve individuale të punës", sipas viteve ka rezultuar si më poshtë:

- |                                                   |          |            |
|---------------------------------------------------|----------|------------|
| • Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2018 | 28 pikë  | Shumë mire |
| • Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2019 | 28 pikë  | Shumë mire |
| • Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020 | 28 pikë  | Shumë mire |
| • Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021 | 28 pikë  | Shumë mire |
| • Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022 | 100 pikë | Shumë mire |

Në periudhën 2019 — 2021 vlerësimi maksimal i punonjësve sipas formularit të vlerësimit ishte me 28 pikë, ndërkohë nga viti 2022 e në vazhdim vlerësimi maksimal është 100 pikë.

Vlerësimi i aftësive individuale të punës sipas standardeve të përcaktuara bëhet nga eprori i drejtpërdrejtë, bazuar në vlerësimin e integritetit, profesionalizmit, komunikimit, qëndrimit konstruktiv, paanshmërisë, punës në grup si dhe planifikimit dhe organizimit të punës.

Bazuar në vlerësimet e mësipërme të administruara në dosjen personale të subjektit, rezulton se subjekti ka përmbushur detyrat profesionale, ka respektuar rregullat e etikës si edhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.

### **Masa Disiplinore**

Nga verifikimet në dosjen personale si dhe në sistemin RMIS, rezulton se gjatë periudhës 5 vjeçare, (2018-2023) të përcaktuar në pikën 2 të nenit 44 të ligjit 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit, nuk është ndëshkuar disiplinarisht me ma së disiplinore.

#### **✚ Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar për vlerësimin e aftësive profesionale, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, arrin në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit Neritan Nallbati:

- ✓ **Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;**
- ✓ **Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;**
- ✓ **Ka vlerësime pozitive pune.**

### **Konkluzione përfundimtare:**

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin e relatores së çështjes, shpjegimet me shkrim të dhëna nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe pasi u njoh me qëndrimin e subjektit të vlerësimit në seancën dëgjimore publike të datës 02.02.2024, ftoj subjektin në seancën e dhënies së vendimit të datës 22.02.2024, dhe arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, z. Neritan Nexhat Nallbati, në përputhje me nenin 60 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- ***Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;***
- ***Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;***
- ***Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.***

## **PËR KËTO ARSYE**

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit Neritan Nallbati me funksion Drejtor i Departamentit të Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Ky vendim u shpall sot datë 20.02.2024, në Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, sot datë 20.02.2024.

**KRYESUES**

**KLEADA MERSINLLARI**

**RELATOR**

**EDONA DUSHAJ**

**ANËTAR**

**ENTON RADOVANI**